

Raiffeisen Bank Shqipëri

Raport Vjetor 2021

Përmbytje

RAPORTI I KËSHILLIT DREJTUES	6
MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM	7
MISIONI -VIZIONI -VLERAT	8
PERSPEKTIVAT DHE PLANET PËR VITIN 2022	9
ORGANET DREJTUESE TË BANKËS	10
RAPORTI I DREJTORISË	12
Zhvillimet Ekonomike	12
Rezultatet Financiare	13
Deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut	17
RAPORTI I SEGMENTEVE	18
Divizioni i Produkteve Korporatë	18
RETAIL BANKING – BANKINGU PËR INDIVIDË	21
Zhvillimi i Segmenteve	21
Divizioni i Produkteve	22
Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Digjital	23
Eksperienca e klientit	26
Kanalet e Shitjes dhe Shpërndarjes	27
THESARI DHE BANKINGU I INVESTIMEVE	28
Të ardhurat fikse	28
Tregu i parasë	29
Këmbimi valutor	30
Njësia e shitjeve	31
PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS	32
BURIMET NJERËZORE	34
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	42
RAIFFEISEN LEASING SH.A	130
RAIFFEISEN INVEST SH.A	132
NJË VËSHTRIM MBI RAIFFEISEN BANK INTERNATIONAL	134
RRJETI I RAIFFEISEN BANK SHA	135
ADRESA	136

DREJTORIA

e Raiffeisen Bank Sh.a



Christian Canacaris
Drejtore i Përgjithshëm, Kryetar i Drejtorisë

Alexander Zsolnai

Zëvendës drejtor i Përgjithshëm,
Zëvendëskryetar i Drejtorisë



Elona Mullahi (Koçi)

Anëtare e Drejtorisë për Biznesin e Korporatave



Vilma Baçe

Anëtare e Drejtorisë për Biznesin Retail



Erion Serti

Anëtar i Drejtorisë për Teknologjinë e Informacionit
dhe Operacionet

Raporti i Këshillit Drejtues

Zonja dhe Zotërinj,

Viti financiar 2021 ishte "viti i rimëkëmbjes dhe rezistencës". Ekonomia e vendit pësoi një rimëkëmbje të ndjeshme për shkak të lehtësimit të masave frenuese, rritjes së konsumit, investimeve dhe eksporteve, duke sjellë një përmirësim të shpejtë, pas ndikimit të pasojave të rënda të tërmetit në Shqipëri dhe pandemisë globale COVID-19.

Raiffeisen Bank sh.a. pati një ecuri shumë pozitive, duke dëshmuar një rritje të ndjeshme të fitimit neto, duke arritur nivelin e para pandemisë dhe në të njëjtën kohë duke tejkaluar tregun për sa i përket rritjes vjetore të aktiveve. Të gjitha linjat e biznesit kontribuan në rezultatin e bankës dhe gjatë periudhës raportuese totali i depozitave dhe i kredive u rritën, duke e mbajtur likuiditetin dhe pozicionin e kapitalit në një nivel të qendrueshëm. Digjitalizimi i produkteve dhe shërbimeve bankare ka shënuar progres të dukshëm. Në emër të Këshillit Drejtues, unë dëshiroj të shpreh mirënjohjen tonë me rezultatet dhe progresin e arritur, të cilat janë përtej pritshmërive.

Gjatë vitit financiar 2021, anëtarët e Këshillit Drejtues zhvilluan 4 takime. Shkalla e pjesëmarrjes në takimet e mbledhjeve të Këshillit Drejtues ishte 100 për qind.

Këshilli Drejtues monitoroi performancën e biznesit dhe zhvillimin e riskut në Raiffeisen Bank sh.a. mbi baza të rregullta dhe në formë gjithëpërfshirëse. Diskutime të rregullta janë zhvilluar me Këshillin Drejtues mbi mjaftueshmërinë e kapitalit dhe likuiditetit, si dhe mbi drejtimin e biznesit të bankës dhe strategjitë e riskut. Këshilli Drejtues gjithashtu është angazhuar me zhvillimet e mëtejshme në qeverisjen e korporatës dhe ka monitoruar në vijimësi zbatimin e politikave përkatëse. Gjatë aktiviteteve të tij monitoruese dhe këshilluese, Këshilli Drejtues mbajti kontakte të drejtpërdrejta me anëtarët përgjegjës të Drejtorisë, audituesin dhe drejtuesit e funksioneve të kontrollit të brendshëm. Këshilli gjithashtu shkëmbeu vazhdimisht informacion dhe ndau pikëpamjet e tij me përfaqësuesit e autoriteteve mbikëqyrëse për tema të veçanta.

Për më tepër, Drejtorja Qendrore e Raiffeisen Bank sh.a. i paraqiti Këshillit Drejtues raporte të rregullta dhe të hollësishme për çështjet përkatëse në lidhje me performancën në fushat përkatëse të biznesit. Gjatë këtyre takimeve, Këshilli Drejtues mbajti kontakte të ngushta me Kryetarin dhe anëtarët e Drejtorisë. Ata kanë qenë të disponueshëm sa herë që u janë kërkuar diskutime dypalëshe ose shumëpalëshe me anëtarët e Këshillit Drejtues dhe, sipas rastit, me pjesëmarrjen e ekspertëve për çështjet që janë ngritur.

Puna e ndërmarrë së bashku me anëtarët e Drejtorisë u bazua në një marrëdhënie besimi të ndërsjellë dhe u zhvillua me një frymë bashkëpunimi efikase dhe konstruktive. Diskutimet kanë qenë të hapura dhe kritike dhe Këshilli Drejtues i ka miratuar rezolutat, pasi i ka shqyrtuar ato në të gjitha aspektet. Nëse është kërkuar informacion më i detajuar për të shqyrtuar çështje specifike më në thellësi, informacioni i nevojshëm është dërguar pa vonesa tek anëtarët e Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues ka kryer detyrat e tij të përcaktuara në legjislacionin bankar shqiptar, Statutin e bankës dhe Rregulloren e Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues diskutoi me vëmendje të veçantë çështje me rëndësi për bankën në formën e Temave në Fokus gjatë mbledhjeve të rregullta të Këshillit Drejtues.

Do të doja të përfitoja nga kjo mundësi për të falenderuar në mënyrë të sinqertë Drejtorinë Qendrore dhe të gjithë punonjësit e Raiffeisen Bank sh.a për përpjekjet e tyre të palëkundura dhe gjithashtu klientët tanë për besimin e tyre të vazhdueshëm.

Në emër të Këshillit Drejtues,



Peter Lennkh,
Kryetar i Bordit të Drejtorëve



Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm

Viti financiar 2021 ka rezultuar të jetë një vit mjaft i suksesshëm për Raiffeisen Bank sh.a., me rezultate shumë të mira të të gjithë treguesve të performancës.

Pavarësisht pandemisë COVID-19 dhe ndikimeve të saj në ekonominë vendase dhe globale, banka qendroi e mirëkapitalizuar dhe me likuiditet të lartë. Falë kontributit të të gjitha linjave të biznesit, fitimi neto pas tatimit (sipas Standardit SNRF) arriti në 3.4 miliardë lekë (ose 28.11 milionë euro) në fund të vitit 2021. Volumi i depozitave është rritur me gati 17 për qind krahasuar me një vit më parë. Aktiviteti kredidhënës u rrit me 21.08 për qind nga viti në vit dhe banka u rendit e dyta me një peshë prej 17.1 për qind të tregut. Raiffeisen Bank ruan pozicionin lider në treg për kredidhënien për individë me një pjesë tregu prej 20.9 për qind, kontributi kryesor vjen nga disbursimet e kredive konsumatore që arritën nivelet e para pandemisë që në muajt e parë të 2021.

Raiffeisen ON, platforma jonë e bankingut digjital vijoi të ketë një performancë të jashtëzakonshme gjatë këtij viti. Platforma është krijuar si për përdoruesit individë ashtu edhe për biznese dhe është pasuruar vazhdimisht me tipare të reja. Edhe këtë vit, Raiffeisen ON është aplikacioni financiar më i shkarkuar dhe më i përdorur në vend, me një depërtim prej 30.2 për qind në bazën e përdoruesve aktivë.

Segmenti i korporatave shënoi rezultate të jashtëzakonshme me huadhënie që arriti 441 milionë euro në fund të vitit 2021, ose 31.4 për qind më e lartë se një vit më parë. Volumet e reja të kredidhënies u rritën me 136 për qind nga viti në vit. Kreditë e gjelbra (ESG) në dhjetor 2021 arritën në 22.8 milionë euro, që përbën 5 për qind të totalit të portofolit të korporatës. Dua të theksoj se Raiffeisen Bank u vlerësua nga klientët e këtij segmenti si Banka më e mirë për bankingun korporatë në vend, bazuar në anketimet e brendshme në lidhje me përvojën e klientit. Banka u vlerësua më shumë se konkurrentët e saj kryesorë falë cilësisë së shërbimit tonë, korrektësisë dhe produkteve novatore.

Për më tepër, ne jemi krenarë që u shërbejmë mbi 480,762 klientëve, individëve dhe bizneseve në të gjithë Shqipërinë duke përmbyllur me lehtësi nevojat e tyre bankare përmes kanaleve tona digjitale dhe duke qenë të pranishëm me rrjetin më të gjerë të degëve dhe ATM-ve në vend. Gjithashtu, ne vijojmë me transformimin digjital për t'i dhënë formë modelit të "bankës së të ardhmes" nëpërmjet degëve "pa shërbime cash- me asistencë njerëzore", ATM-ve multifunksionale dhe planeve të tjera që do të reduktojnë transaksionet me para cash brenda degës dhe do t'i drejtojnë klientët më shumë drejt zgjidhjeve digjitale.

Raiffeisen Invest sh.a. ka përmbyllur vitin financiar 2021 me rezultate mjaft të kënaqshme, pavarësisht vështirësive të këtij viti dhe luhatsmërisë së lartë të tregut. Ajo ruajti pozicionin dominues në tregun shqiptar për fondet e investimeve, me 94 për qind të tregut duke regjistruar rreth 613 milionë euro aktive si në fondet e investimeve, ashtu edhe në fondet e pensioneve vullnetare. Raiffeisen Invest sh.a. ka përparuar drejt transformimit digjital duke prezantuar "Modulin e Investimeve" në platformën digjitale Raiffeisen ON, duke u bërë kështu shoqëria e parë e menaxhimit të aktiveve në treg që ofron shërbime digjitale për klientët e saj.

Gjithashtu, Raiffeisen Leasing sh.a. ka vazhduar të jetë lider në tregun e brendshëm, për dhënie me qira financiare të automjeteve dhe pajisjeve. Shumica e volumeve të reja përbëhen nga subjekte tregtare që kontribuojnë me 83 për qind në volumnin total. Qëllimi i shoqërisë është të forcojë partneritetin afatgjatë me klientët, duke u ofruar atyre mbështetjen efikase që u nevojitet në biznesin e tyre.

Ne kemi pritshmëri që viti 2022 të jetë një vit shumë i mirë pasi Raiffeisen Bank sh.a. ka një pozicion të fortë financiar dhe jemi të gatshëm t'u bëjmë ballë sfidave të reja. Ne do të vijojmë të investojmë më shumë në zgjidhjet digjitale dhe të prezantojmë produkte të reja ose të përmirësuara digjitale në të gjitha segmentet tona bankare. Cilësia e shërbimeve ndaj klientit në të gjitha segmentet tona do të vazhdojë të mbetet prioritet. Gjithashtu, do të vijojmë të fokusohemi në zhvillimin personal të punonjësve tanë.

Në përmbyllje, në emër të Drejtorisë, unë dua të shpreh sinqerisht mirënjohjen time për të gjithë klientët tanë dhe partnerët e biznesit për besimin dhe bashkëpunimin e tyre gjatë vitit 2021. Gjithashtu dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për të gjithë punonjësit tanë, për përkushtimin, punën në ekip dhe përpjekjet e tyre drejt përmbylljes së qëllimeve të biznesit. Ne mbetemi të përkushtuar për të vazhduar transformimin dhe përshtatjen për t'u bërë një organizatë pararojë që është gati për epokën e ardhshme të bankingut.

Christian CANACARIS

Drejtore i Përgjithshëm, Kryetar i Drejtorisë



Vizioni & Misioni

Vizioni ynë për vitin 2025

Të jemi grupi bankar më i rekomanduar për shërbimet financiare.

Misioni

Ne transformojmë inovacionin e vazhdueshëm në eksperiencë të shkëlqyer për klientët.

Vlerat



Bashkëpunim

Kur punojmë bashkë, komunikojmë bashkë, dëgjojmë dhe mbështesim njëri tjetrin përfitimet e përbashkëta janë shumë më të mëdha. Synimi ynë është të ndërtojmë vazhdimisht një mjedis mirëkuptimi, respekti dhe besimi reciprok.




Proaktivitet

Ne besojmë te vizioni ynë për të ardhmen. Nxisim ndryshimin, duke u përqendruar te mundësitë dhe jo pamundësitë. Shkëmbejmë pavendosmërinë me vendosmërinë. Veprojmë, nuk reagojmë.



Të mësuarit

Të mësuarit e vazhdueshëm do të thotë zhvillim personal. Mësojmë nga përvoja, edukimi dhe ndarja e njohurive me njëri-tjetrin.



Përgjegjshmëri

Kur çdonjëri nga ne mbart përgjegjësi për veprimet që ndërmerr ndryshimi rezulton i madh. Individualisht dhe së bashku jemi përgjegjës për vendimet, rezultatet dhe pasojat e veprimeve tona.

Planet dhe Perspektiva për Vitin 2022

Raiffeisen Bank synon të vijojë në vitin 2022 zhvillimin e saj dhe të kontribuojë më tej në ekonominë e vendit, pavarësisht përballjes me kriza të njëpasnjëshme. Përpjekja për të përmirësuar përvojën e klientit dhe për t'u mundësuar klientëve tanë të kenë progres në jetën dhe biznesin e tyre janë misioni primar në botëkuptimin e Raiffeisen. Raiffeisen Bank do të jetë edhe më afër klientit në këto kohë sfiduese duke vlerësuar me vëmendje pozicionin e klientëve tanë, në këto kohë të vështira të krizës energjetike, ku BE-ja është ngërthyer nga rritja e çmimeve globale të gazit natyror, i cili përdoret për ngrohjen e shtëpive dhe për të prodhuar elektricitet.

Transformimi digjital do të jetë synimi kryesor i të gjitha segmenteve tona bankare, si një mundësi për të rritur vlerën e klientëve tanë në këtë mjedis përçarës. Ne do të investojmë më tej në platformat tona digjitale për të ruajtur pozicionin tonë lider duke përfaqësuar bankën më inovative dhe më të avancuar në vend. Në këtë kontekst, ne planifikojmë të pasurojmë platformën tonë digjitale 'Raiffeisen ON' me veçori dhe funksionalitete të reja veçanërisht duke digjitalizuar ofertën tonë të kredive. Më tej, cilësia e shërbimeve ndaj klientit në të gjitha segmentet tona do të vijojë të mbetet prioritet. Segmentet individ, korporata dhe SE do të vazhdojnë të fokusohen në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve më të mira të klientëve në treg, si shërbimet bankare digjitale, metodat inovative të pagesës, kreditë, etj.

Ne do të vijojmë të fokusohemi në zhvillimin personal të punonjësve tanë, për të përfunduar standardet më të larta të shërbimit ndaj klientit. Ne vlerësojmë ekspertizën dhe krijojmë një mjedis pune që promovon bashkëpunimin, kreativitetin dhe shpirtin sipërmarrës. Një mënyrë transformuese e punës do të lejojë më shumë bashkëpunim dhe do të rrisë kreativitetin e punonjësve tanë. Ne do të eksperimentojmë me mënyrat e reja pararojë të punës, të cilat po marrin formë në tregjet më të zhvilluara në mbarë botën, duke i ofruar punonjësit tonë mundësinë për të punuar me kohë të pjesshme nga shtëpia. Puna hibride midis zyrës dhe shtëpisë do të kontribuojë më tej në zhvillimin e forcës sonë punëtore. Ndërkohë, ne do të vazhdojmë të përmirësojmë rrjetin e degëve në përputhje me transformimin tonë digjital, për të ofruar degë bashkëkohore dhe miqësore me klientët.

Së fundi, Raiffeisen Bank do të rrisë fokusin e saj në një qasje gjithëpërfshirëse të zbatimit për të gjitha grupet e klientëve me synimin për të kontribuar cilësisht në rritjen e biznesit të RBAL përmes bankingut të përgjegjshëm. Në këtë botë me ndryshim galopant dhe në kuadër të ndryshimeve klimatike, me rritjen e temperaturave që ekspozojnë ndaj fatkeqësive klimatike, ne do të bëjmë më të mirën për të zbatuar operacione bankare me përgjegjësi mjedisore dhe shoqërore në të gjithë Raiffeisen Bank Shqipëri. Raiffeisen Bank do të japë gjithashtu kontributin e saj në këtë ndryshim epokal duke sponsorizuar projekte sociale që shkojnë në të njëjtin drejtim dhe ndihmojnë në zbutjen e ndryshimeve të temperaturës në nivele të menaxhueshme.

Drejtoria

Raiffeisen Bank Sh.a



Christian Canacaris

Drejtor i Përgjithshëm,
Kryetar i Drejtorisë



Alexander Zsolnai

Zëvendësdrejtor
i Përgjithshëm,
Zëvendëskryetar i
Drejtorisë



Elona Mullahi (Koçi)

Anëtare e Drejtorisë për
Biznesin e Korporatave



Vilma Baçe

Anëtar i Drejtorisë për
Biznesin Retail



Erion Serti

Anëtar i Drejtorisë
për Teknologjinë e
Informacionit dhe
Operacionet

Organet Drejtuese të Bankës

KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues është përgjegjës për miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të bankës, në lidhje me planin e biznesit, menaxhimin e rrezikut, buxhetin vjetor, përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave, monitorimin e efikasitetit të praktikave të drejtimit të bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave, etj.

Anëtarët e Këshilli Drejtues

Peter Lennkh	Kryetar
Heinz Wiedner	Zëvendëskryetar
Harald Kreuzmair	Anëtar
Slavoljub Dordevic	Anëtar
Thomas Matejka	Anëtar

KOMITETI I KONTROLLIT

Komiteti i Kontrollit kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte; kryen vlerësimin e situatës financiare të bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar, etj.

Anëtarët e Komitetit të Kontrollit

Heinz Wiedner	Kryetar
Ulf Leichenring	Zëvendëskryetar
Johannes Kellner	Anëtar

KOMITETI I RREZIKUT

Komiteti i Rrezikut këshillon Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues në lidhje me strategjinë dhe oreksin e përgjithshëm aktual dhe të ardhshëm të rrezikut, si edhe ndihmon Drejtorinë dhe Këshillin Drejtues për të mbikëqyrur zbatimin e kësaj strategjie nga drejtuesit e lartë të bankës.

Anëtarët e Komitetit të Rrezikut

Thomas Matejka	Kryetar
Harald Kreuzmair	Zëvendëskryetar
Heinz Wiedner	Anëtar

DREJTORIA

Drejtoria organizon dhe drejton në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e bankës; përcakton dhe delegon detyrat të personeli, si edhe mbikëqyr ushtrimin e përgjegjësi të deleguara, në përputhje me politikën dhe procedurat e miratuara; ndërmer masat e nevojshme për të monitoruar dhe administruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka, në përputhje me strategjitë e miratuara, si dhe siguron që proceset e administrimit të rrezikut të jenë në përshtatje të vazhdueshme me profilin e rrezikut të bankës dhe planin e biznesit të miratuar.

Anëtarët e Drejtorisë

Christian Canacaris
Alexander Zsolnai
Elona Mullahi
Egon Lerchster

Kryetar/Drejtor i Përgjithshëm
Zëvendëskryetar/Zv. drejtor i Përgjithshëm
Anëtare
Anëtar

Raporti i Drejtorisë

Zhvillimet Ekonomike

Ekonomia performoi në mënyrë të shkëlqyer në 2021 duke u rikuperuar shumë shpejt nga rënia me -3,5% në vitin 2020. PBB-ja u rrit me ritëm të përsheptuar prej 8,5% pasi kufizimet e lehtësuara në lëvizjen e njerëzve dhe vaksinimi i vazhdueshëm nxitën konsumin, investimet, të inkurajuara nga një sezon i mirë turistik. Zgjerimi ishte me bazë të gjerë në të gjithë komponentët e shpenzimeve; eksportet e mallrave dhe shërbimeve shënuan rritjen më të madhe me 46,5% në terma vjetorë, të ndjekur nga importet e mallrave dhe shërbimeve me një rritje vjetore prej 31,7%. Kontribuues të tjerë ishin formimi i kapitalit bruto me +19,9%, konsumi publik +8,2% në terma vjetorë dhe konsumi familjar me vetëm 4,1%. Duke parë në perspektivë 2022-shin, ekonomia pritet të ruajë hovin pozitiv, por do të ndikohet nga pasiguria e rritura nga lufta në Ukrainë. Pasoja indirekte të kësaj lufte në ekonomi do të vijnë nëpërmjet rritjes së inflacionit dhe si pasojë dekurajim të konsumit privat, i cili do të çojë në një rritje reale të PBB-së prej 3,4% në terma vjetorë bazuar në parashikimin tonë më të fundit.

Norma e inflacionit në vitin 2021 u rrit mesatarisht në 2,0% krahasuar me 1,6% në vitin 2020, duke mbetur nën objektivin prej 3,0% të Bankës së Shqipërisë. Në pjesën e dytë të vitit, norma e inflacionit filloi të rritet, si pasojë e ngritjes së çmimeve të ushqimeve dhe energjisë elektrike në tregjet botërore. Në muajin dhjetor, inflacioni arriti në nivelin më të lartë të vitit, me 3.7%, me kontributin kryesor nga çmimet e ushqimeve dhe naftës. Gjithashtu, inflacioni bazë u rrit në 2.6% në dhjetor 2021. Politika monetare vazhdoi të jetë lehtësuese me një normë bazë historike të ulët prej 0,5%. Presionet e inflacionit do të jenë të pranishme në vitin 2022, me rreziqe të rritura pas luftës në Ukrainë. Prandaj, Banka e Shqipërisë zgjodhi të veprojë paraprakisht në mars 2022, duke nisur një cikël shtrëngues të politikës monetare për të luftuar presionet e larta të pritshme nga inflacioni dhe për të ruajtur një kurs të qendrueshëm të kursit të këmbimit. Kështu, norma bazë u rrit me 50 pikë bazë në nivelin e tanishëm prej 1,0%. Megjithatë, me forcimin e presioneve të inflacionit, cikli shtrëngues pritet të vazhdojë edhe në pjesën e dytë të vitit 2022.

Efektet e pandemisë në tregun e punës u zbutën në vitin 2021, duke pasur parasysh se shkalla e papunësisë ra në 11,4% në fund të 2021, pasi arriti kulmin në 11,9% në tremujorin e parë të 2021. Megjithatë, shkalla e papunësisë u rrit lehtësisht në krahasim me 11,3% në TM3 2021, përmirësim i arritur nga një sezon i shkëlqyer turistik. Shifra vjetore e papunësisë ra në nivelin e para pandemisë prej 11,5% nga 11,7% në 2020. Për më tepër, shkalla e punësimin u rikuperua në 53,5% në fund të 2021 nga 52% që ishte në 2020 dhe paga mujore bruto u rrit me 8,4% në vit në TM4 2021 (kundër vetëm 2,8% në 2020) duke konfirmuar rimëkëmbjen e tregut të punës.

Politika fiskale vazhdoi të jetë lehtësuese edhe në vitin 2021 për të mbështetur rimëkëmbjen e ekonomisë nga plagët e pandemisë dhe tërmetit. Prandaj, deficitin buxhetor ishte 4,8% e PBB-së në fund të vitit 2021, ose shumë më lart se niveli para-pandemisë prej më pak se 2,0% e PBB-së, por dukshëm më i ulët krahasuar me 6,7% në 2020. Rimëkëmbja e fortë e ekonomisë dhe çmimet më të larta në pjesën e dytë të vitit ndihmuan të ardhurat buxhetore, të cilat u rritën me 19,9% në terma vjetorë në vitin 2021. Nga ana tjetër, shpenzimet buxhetore u rritën me 11,1% në terma vjetorë. Megjithatë, kjo dinamikë nuk u reflektua në borxhin e qeverisë, i cili ra në 73,2% të PBB-së nga 74,5% në vitin 2020. Ne presim që politika fiskale të mbetet lehtësuese në vitin 2022 me një deficit buxhetor prej 4.2% të PBB-së e me një rënie më të shpejtë të borxhit publik në vitet në vijim.


Pozicioni i jashtëm i vendit u përkeqësua lehtësisht në vitin 2021, me deficitin e llogarisë rrjedhëse prej 1,2 miliardë eurosh, duke u zgjeruar me vetëm 2,9% krahasuar me një vit më parë. Llogaria e shërbimeve u rrit nga të ardhurat nga turizmi (2,6 herë më shumë se në vitin 2020), ndërkohë që deficitin tregtar u përkeqësua me 28,4% në terma vjetorë. Në vitin 2021, investimet e huaja direkte arritën në nivelin 1,0 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.2%, ndërsa remitancat shënuan 761 milionë euro, duke u zgjeruar me 13,0% krahasuar me një vit më parë.

Aktiviteti i sektorit bankar u zgjerua ndjeshëm në vitin 2021, me një normë vjetore rritjeje të aktiveve prej 12,1% (7,2% në 2020), kryesisht si pasojë e aktivitetit ndërbankar dhe investimeve në letra me vlerë. Aktiviteti kredidhënës u përsheptua në vitin 2021 duke u rritur me 9,4% në 2021 kundrejt 5,8% në 2020, duke reflektuar zgjerimin e volumit të kredisë në të dy segmentet: individ (10,6%) dhe biznes (8,9%). Përmirësimi i niveleve të besimit nxit një kërkesë më të lartë për kredi dhe së bashku me standardet e relaksuara të kredidhënës favorizuan zgjerimin e aktivitetit kredidhënës. Gjithashtu, potenciali mbetet i lartë me pozicionin e likuiditetit dhe kapitalin në një nivel optimal të nxitur së bashku nga një raport i ulët kredi ndaj depozitave (44,5%). Megjithatë, ka rreziqe negative për kërkesën për kredi (veçanërisht kredi hipotekore dhe për investime) për shkak të rritjes së pasigurisë nga lufta në Ukrainë. Kështu, aktiviteti kredidhënës mund të pengohet disi për shkak të rritjes së inflacionit të pritshëm dhe uljes së konsumit privat.

Rezultatet Financiare


Totali i aktiveve në fund të vitit 2021 ishte 273,400 milionë Lekë (2020: 237,554 milionë Lekë). Në 2021 portofoli i kredisë, përfaqësonte 39 përqind (2020: 37 përqind) të totalit të aktiveve të bankës. Investimet në letra me vlerë përfaqësojnë rreth 29 përqind të totalit të aktiveve në 2021 (2020: 25 përqind). Ndërsa Arkat dhe llogaritë me bankat janë ulur me 5% nga viti në vit.

Struktura e Bilancit - Aktivi
(në '000 LEK)



Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2021 ishte 116,634 milionë Lekë (2020: 99,440 milionë Lekë) duke përfaqësuar kështu një rritje prej 17 përqind të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Sektori i Korporatave përfaqëson 51 përqind të totalit të portofolit të kredisë dhe zuri vendin kryesor në këtë portofol me një tepricë kredisë prej 59,040 milionë Lekë (2020: 44,506 milionë Lekë). Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme shënuan një rënie prej 29 përqind dhe Ndërmarrjeve të Vogla shënuan një rritje në portofolin e kredisë prej 45 përqind me një tepricë prej 10,145 milionë Lekë (2020: 13,171 milionë Lekë).


Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët
(në '000 LEK)



Totali i detyrimeve në fund të vitit 2021 ishte 243,249 milionë Lekë (2020: 207,128 milionë Lekë). Në 2021, pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë rreth 93 përqind (2020: 97 përqind) të totalit të detyrimeve.

Struktura e Bilancit - Pasiv


(në '000 LEK)



2021 shënoi një rritje prej 104 përqind të fitimit pas taksës në krahasim me 2020 në 3,412 milionë Lekë (2020: 1,673 milionë Lekë). Dividendi i deklaruar dhe i paguar në 2021 është 3,688 milionë Lekë (2020: 0 milionë Lekë). Grupi ka një profil të qëndrueshëm kapitali me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 20.30 përqind, shumë më tepër se kërkesa minimale rregulatore prej 12 përqind.

Struktura e Kapitalit Aksioner


(në '000 LEK)



Shpenzimet administrative në total gjatë 2021 arritën në 2,066 milionë Lekë (2020: 1,839 milionë Lekë). Në vitin 2021 raportit kosto/të ardhura pësoi një rënie nga 56.59 përqind në 52.5 përqind.

Shpenzime operative 2021

(në '000 LEK)




Shpenzime për zyrat	11%
Shpenzime për IT	40%
Tarifa konsulence dhe ligjore	12%
Shpenzimet gjyqësore që nuk mbulohe nga provizionet	0%
Shpenzimet që lidhen me rrezikun e kredisë	2%
Shpenzime marketingu	12%
Shpenzime për komunikim	1%
Pajisje zyre	1%
Shpenzime për makinat	2%
Shpenzime sigurie	5%
Shpenzime udhëtimi	0%
Shpenzime për qiratë	0%
Taksa të tjera	2%
Trajnim Personeli	1%
Shpenzime te ndryshme administrative	10%

Edhe pse të ardhurat neto nga interesat të Grupit kanë pësuar një rritje prej 3.24 përqind dhe totali i bilancit të Bankës u rrit me (15.1 përqind) për shkak të tepricës së likuiditetit, kjo rezultoi në rënien e marzhit të interesit (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) që është 2.66 përqind në 2021 nga 2.85 përqind në 2020.


Të ardhura neto

(në '000 LEK)



Fitimi & ROE

(në '000,000 ALL)



Deklarata e oreksit/tolerancës ndaj rrezikut

Struktura e Tolerancës ndaj Rrezikut (RAF) synon t'i ofrojë menaxhimit, së bashku me formulimin dhe miratimin e një Deklarate të Tolerancës ndaj Rrezikut nga lart-poshtë, një instrument për të vendosur dhe kufizuar nivelin e rrezikut të përgjithshëm që banka është e gatshme dhe e aftë të marrë përsipër në mënyrë që të arrijë qëllimet e saj strategjike dhe të biznesit. Ekziston një ndërlidhje e ngushtë me Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (ICAAP) pasi objektivi kryesor i RAF është të harmonizojë objektivat strategjike dhe ato të biznesit me domosdoshmërinë për të përmbushur kërkesat minimale rregullatore të kapitalit në skenarë të pafavorshëm, si dhe në rastin e ngjarjeve të rënda të veçuara të rrezikut dhe për të siguruar që kreditorët e mëdhenj të mos pësojnë humbje në një skenar rreziku ekstrem. Banka e Shqipërisë parashikon që banka të mbajë një sasi minimale kapitali për të gjitha rreziqet e saj materiale. Për të ashtuquajturat rreziqe të Shtyllës 1 (d.m.th. rreziku i kredisë, rreziku i tregut dhe rreziku operacional) parashikohen procedura të qarta sasiore dhe vlerësimi; dhe mbledhja e këtyre rezultateve gjeneron kërkesën për kapital rregullator. Menaxhimi i rrezikut në Raiffeisen Bank duhet të sigurojë që kërkesat e kapitalit rregullator janë përmbushur. Raiffeisen Bank mban kapital më shumë se kërkesa minimale rregullatore si një masë mbrojtëse shtesë për të shmangur ndërhyrjen rregullatore dhe humbjet pasuese të cënimit të reputacionit. Ky nivel kapitali quhet kapaciteti për ndërmarrjen e rrezikut ("RTC") i shprehur ndryshe si Kapitali Rregullator që është shuma e: Kapitali i përbashkët i nivelit 1, kapitali shtesë i nivelit 1, dhe kapitali i nivelit 2. Niveli i kapitalit të mbajtur nga Banka gjithashtu kontribuon në rritjen e aktivitetit të biznesit dhe ecurinë e ardhshme. Meqenëse RTC bazohet kryesisht në tepicën e kapitalit mbi kërkesën për kapital minimal ("MCR"), nevojitet një përkufizim i MCR për konceptin RTC (Deklarata e Tolerancës ndaj Rrezikut). Në përgjithësi, MCR (Kërkesa për Kapital Minimal) është kërkesa e nevojshme për kapitalin rregullator për rreziqet e Shtyllës I (përkatesisht rreziku i kredisë, rreziku i tregut dhe rreziku operacional). Për të pasur një nivel optimal të kapitalit të mbajtur, gjatë vlerësimit të nivelit të RTC-së, aksionerët duhet të jenë të vetëdijshëm se përveç nivelit të MCR-së, Banka mund të përballet edhe me ngjarje të cilat mund të shkaktojnë rreziqe të paparashikuara dhe/ose të pamatshme. Këto lloj rreziqesh vlerësohen sipas kërkesës kapitale të Shtyllës II, e cila përbëhet nga kërkesa për: rrezikun e përqendrimit të kredisë, rrezikun e mbetur, rreziqet që rrjedhin nga çdo faktor i jashtëm mjedisor (d.m.th. stres testi) dhe çdo rrezik të referuar si lloje të tjera të rrezikut, që vlerësohen në baza vjetore përmes procesit të vlerësimit të rrezikut. Duke pasur parasysh paqendrueshmërinë në tregjet financiare dhe mjedisin ekonomik, si dhe paparashikueshmërinë e ngjarjeve të mëdha të rrezikut, oreksi i rrezikut duhet të vendoset nën nivelin e tolerancës ndaj rrezikut me masa mbrojtëse të konsiderueshme në mënyrë që të shmangët një shkelje e shpeshtë e nivelit të synuar të paralajmërimit RTC. Oreksi i rrezikut përkufizohet si kufiri prej 85 përqind i RTC-së së synuar. Toleranca ndaj rrezikut përcaktohet nga kufiri prej 95 përqind i Kapacitetit të synuar për ndërmarrjen e rrezikut. Objektivat përcaktohen në përputhje me Buxhetin dhe Procesin e Planifikimit Afatmesëm dhe përfshin masat mbrojtëse të përshtatshme menaxheriale për të mbuluar luhatshmërinë e zakonshme të kushteve të tregut.

Ekspozimet e ponderuara me rrezikun (në mijë EUR)	2022	2023	2024
Rreziku i Kredisë	892205,97	958742,03	1005244,72
Rreziku i Tregut	10142,00	10166,06	10174,10
Rreziku Operacional	143007,52	147171,90	158295,46

	Dhjetor 2021
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit Rregullator	20,30%
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit në përputhje me metodologjinë vendase të ICAAP	19,31%

Raporti i Segmenteve

Divizioni i Produkteve Korporatë

Gjatë vitit 2021, segmenti korporatë vijoi të forcojë pozicionin e tij në tregun vendas. Në nivel segmenti, portofoli i kredisë shënoi një rritje prej 31,4% krahasuar me një vit më parë, duke shënuar një nga vitet më të suksesshme që nga themelimi.

Fitimi neto pas tatimit shënoi një rritje prej 113% krahasuar me një vit më parë, i gjeneruar nga volumet e larta të kredidhënies mbi buxhet dhe në kombinim me volumet e transaksioneve nga produktet e administrimit të cash-it në segmentin korporatë.

U zhvilluan shumë iniciativa dhe fushata për të arritur zonën operacionale të shërbimeve, veçanërisht në aktivitetin kredidhënës, duke rritur me 10% bazën e klientëve huamarrës.

Me qëllim përmirësimin e eksperiencës së klientëve, viti 2021 shënoi një moment historik të rëndësishëm përmes prezantimit të konceptit "skudrave ndërfunksionale të huadhënies" në zonën e korporatave.

Qëllimi i këtij riorganizimi të brendshëm është të kthehemi në një organizatë të përgjegjshme, të përshtatemi shpejt dhe të krijojmë një përvojë të mirë ndaj klientit. Përshtatja e metodologjisë së Agile nëpërmjet krijimit të ekipeve ndërfunksionale të huadhënies me palë interesi nga divizioni i biznesit, riskut dhe atij ligjor, kontribuon drejtpërdrejt në reduktimin e kohës së nevojshme për procesimet e produkteve të huadhënies.

Së bashku me këtë riorganizim, viti 2021 shënoi një ndryshim në kriteret e segmentimit bazuar në qarkullimin vjetor të klientëve të korporatave, për t'i shërbyer më mirë nevojave të klientit. Aktualisht klientët shërbehen nga dy segmente:

- Korporatat e mëdha
- Korporata të mesme

"Skudrat ndërfunksionale të huadhënies" monitorojnë nga afër edhe performancën e klientëve, e cila reflektohet në cilësi më të mirë të portofolit.

Si pjesë e strategjisë afatgjatë, Raiffeisen është fokusuar në ndikimin pozitiv në ekonominë e përgjithshme shqiptare nëpërmjet rritjes së standardeve bankare në treg. Në këtë drejtim, Banka ka investuar vazhdimisht në ruajtjen dhe rritjen e një partneriteti afatgjatë të konsoliduar me të gjitha Institucionet Publike, Qeverisjen Qendrore dhe Vendore, duke luajtur një rol thelbësor në mbështetjen e projekteve të rëndësishme infrastrukturore, përmes prezantimit të zgjidhjeve novatore të teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve bankare. Kjo sinergji e ka renditur Raiffeisen si bankën partnere kryesore të qeverisë shqiptare.

Dëshmi nga klienti

Energy Financing Team (Zvicër) AG, pjesë e Grupit EFT, filloi bashkëpunimin me Raiffeisen Bank Albania në vitin 2021 për një lehtësi financimi. Ne përfunduam me sukses një transaksion të madh Factoring (financimi) në 2021/2022, i cili shprejsojmë se do të shënojë vetëm marrëveshjen e parë të një partneriteti afatgjatë.

Na ka bërë vazhdimisht përshtypje profesionalizmi dhe mbështetja që ka dhënë ekipi i Raiffeisen Bank Albania. Ata kanë demonstruar njohuri të thella të tregut dhe një kuptim të qartë të tregut të energjisë në Shqipëri. Ekspertiza e ekipit të RB Albania na ka lejuar të zhvillojmë së bashku ide novatore për bashkëpunim.

Personi i kontaktit:

Ivan Jennings

ivan.jennings@eft-group.net

+41 71 226 1039

Njësia e financimit të projekteve dhe Agri Biznesit

Njësia e Financimit të Projekteve është e përkushtuar të vlerësojë nevojat për financim dhe të ndihmojë në lehtësimin e këtyre shërbimeve në lidhje me projektet afatgjata industriale dhe në "Pasuri të paluajtshme", si dhe për transaksionet e strukturuar afatgjata si "shkrirje" dhe "blerje". Gjatë vitit 2021 portofoli i financimit të projektit u rrit ndjeshëm. Ne në RBAL, jemi të hapur për të financuar projekte në të gjithë sektorët, me kusht që projekti të jetë i realizueshëm dhe në përputhje me kriteret tona të kreditimit.

Duke filluar nga viti 2021 dhe në të ardhmen, fokusi ynë është të financojmë projekte sociale dhe të gjelbra, në mënyrë që të jenë të sinkronizuar me transformimin e qendrueshëm mbarëbotëror.

Ne mbetemi të fokusuar të financojmë sektorin e energjisë së rinovueshme, i cili për momentin përfshin projektet e hidrocentraleve dhe paneleve diellore.

Ne jemi vazhdimisht të fokusuar për të rritur bashkëpunimin me klientët tanë, të cilët gjejnë në Raiffeisen Bank një partner të jashtëzakonshëm, duke ofruar produkte dhe zgjidhje të personalizuar në përputhje me praktikat më të mira të tregut. Përvoja profesionale dhe kompetencat e shfaqura gjatë bashkëpunimeve tona, e kanë renditur Bankën Raiffeisen si një partner të vlefshëm mes institucioneve financiare ndërkombëtare, duke u bërë një palë aktive e sindikatave financuese kombëtare dhe ndërkufitare.

Në një mjedis dinamik tregu, cilësitë kryesore që na dallojnë janë kreativiteti, kompetenca dhe transformimi i vazhdueshëm.

Financimi i agri biznesit - Një tjetër histori suksesi ishte marrëveshja e nënshkruar në Mars 2019 ndërmjet RBAL, BERZH dhe Qeverisë Shqiptare, duke e mbështetur portofolin e kredisë në vlerën 35 milionë euro. Duke marrë në konsideratë zhvillimin e tregut, ne jemi duke negociuar me BERZH për të zgjeruar spektrin e financimit, duke përfshirë edhe sektorin e turizmit. Ky bashkëpunim është në përputhje edhe me politikën e qeverisë sonë për të mbështetur sektorin e bujqësisë dhe turizmit.

Në vazhdimësi të bashkëpunimit tonë me BERZH-n, në shtator 2020 ne kemi nënshkruar një tjetër marrëveshje për ndarjen e rrezikut financiar në vlerën 50 milionë euro. Marrëveshja synon të rrisë portofolin e kredisë së Bankës për të ndihmuar korporatat të jenë të suksesshme dhe konkurruese në treg, por njëkohësisht duke mbajtur nën kontroll aktivitetet e ponderuara me risk.

Njësia e Menaxhimit të Produkteve të Likuiditeteve

1- Skanoni kodin QR për pagesën e faturave elektronike

Banka Raiffeisen, me një fokus të përhershëm tek inovacioni, vazhdon ofrimin e produkteve për klientët e saj. Risia më e fundit në digjitalizimin e produkteve dhe proceseve për klientët e biznesit si një domosdoshmëri për të lehtësuar punën e përditshme për shkak të ligjit rregullator të qeverisë për fiskalizimin, është edhe mundësia për të skanuar kodin QR nga aplikacioni mobile në faturën elektronike.

Duke skanuar kodin QR nëpërmjet kamerës së aplikacionit celular RON, të gjitha të dhënat që përmban fatura elektronike plotësohen automatikisht. Ky është një funksion i ri i prezantuar nga banka Raiffeisen, duke na renditur si Bankën e parë në tregun shqiptar që lehtëson mënyrën për të paguar faturat elektronike me një klikim.

2- Çelja e llogarive online

Për herë të parë në Shqipëri, shoqëritë do të kenë mundësinë të aplikojnë online për një llogari të re dhe për një llogari shtesë në monedha të ndryshme. Platforma jonë digjitale ofron një mundësi të tillë duke qenë gjithmonë një hap para inovacionit dhe duke ofruar funksionalitete të reja me synim lehtësimin e aktivitetit ditor të bizneseve, automatizimin dhe shkurtimin e proceseve. Kurseni kohë, trafik, radhë dhe punë nga komforti i zyrës suaj.

3- Limitet e financimit dhe kërkesat për disbursim

Gjatë vitit 2021, ne kemi pasuruar platformën tonë me shërbime të reja për Produktet e huadhënies për klientët tanë të biznesit. Ne jemi banka e parë në Shqipëri që i ofrojmë tashmë klientëve tanë biznes mundësinë për të parë përmes platformës sonë digjitale një pasqyrë të të gjithë limiteve të financimit të miratuara nga banka, detajet përkatëse, produktet e disbursuara për çdo kontratë dhe limitet e disponueshme për përdorim. Nëpërmjet këtij funksionaliteti të ri, klientët mund të bëjnë një kërkesë për disbursim për pjesën e papërdorur të limitit ekzistues, duke plotësuar dy formularë disbursimi të një produkti të ri dhe rritjen e shumës së një produkti ekzistues.

Produktet e Financave Tregtare

Njësia e Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër ka vijuar edhe gjatë vitit 2021 të mbështesë klientët e saj Korporatë në të gjitha çështjet që lidhen me realizimin e transaksioneve në fushën e Financave Tregtare dhe me përdorimin e produkteve të Financimit Afatshkurtër.

Ne kemi ruajtur pjesën tonë të tregut në Produktet e Financave Tregtare gjatë vitit 2021, falë ekipit tonë të përkushtuar që mbështet dhe këshillon nga afër klientët tanë, për të kuptuar dhe strukturuar më mirë nevojat e tyre për këto produkte, dhe për të minimizuar riskun në tregtinë ndërkombëtare.

Raiffeisen Bank ka vijuar të ruajë një nivel të lartë specializimi, i cili përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes trajnimit të rregullt të specialistëve, mbështetjes së bankës Raiffeisen Bank International AG, Vjenë, bashkëpunimit me bankat e rrjetit si dhe duke shfrytëzuar strukturat e saj të balancuara dhe kanalet e gjera të shpërndarjes.

Gjatë vitit 2021, Njësia e Produkteve të Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër, në bashkëpunim me forcën shitëse, ka intensifikuar komunikimin me klientët e segmentit Korporatë të bankës për të rritur nivelin e tyre të njohjes së produktit të Faktoringut (financimit) dhe avantazhet e përdorimit të tij, si dhe për të nxitur këtë segment klientësh që të konsiderojë produktin e Faktoringut (financimit) si një mundësi alternative për financimin dhe menaxhimin më efektiv të nevojave të tyre afatshkurta për likuiditet.

Retail Banking

Zhvillimi i Segmenteve

Segmenti i Klientëve Individë

2021 vazhdoi të ishte një vit sfidues. Situata e zgjatur e pandemisë solli pasiguri të lartë në shumë aspekte të jetës shoqërore dhe ekonomike, duke na përballur me sfida të reja, nevoja të reja të klientëve, mënyra të reja të ofrimit të produkteve dhe shërbimeve tona dhe për rrjedhojë dhe me pritshmëri të tjera të klientëve ndaj shërbimit bankar. Pavarësisht kësaj, ne arritëm të rritim bazën tonë të klientëve me 13%, duke forcuar marrëdhënien dhe duke rritur aktivitetin e tyre me bankën.

Arritje shumë e rëndësishme është që klientët tanë pagamarrës shënuan një rritje me 5%, me një performancë pozitive në të dy sektorët, atë publik dhe privat, duke treguar qendrueshmërinë dhe pozicionin tonë lider në këtë treg. Fokusi për segmentin individë vazhdon të jetë rritja e veprimtarisë bankare të klientëve, nxitja e marrëdhënieve primare dhe afrimi i klientëve të rinj, kryesisht të moshave të reja të popullatës.

Segmenti Premium

Banka Raiffeisen udhëheq tregun bankar në shërbim të avancuar të klientëve Premium që prej vitit 2010. Aktualisht janë afërsisht 12 000 klientë në segmentin Premium me kërkesa të ndryshme bankare, duke filluar nga kërkesat primare e deri tek ato më komplekse, të cilat kërkojnë këshillim të plotë financiar. Menaxherët e dedikuar Premium janë të lokalizuar në 15 degë në qytetet më të mëdha të vendit, të cilët jo vetëm që ofrojnë një shërbim të personalizuar, por janë të trajnuar edhe në këshillimin financiar.

Për të përmbushur edhe më mirë nevojat e këtij segmenti, ne prezantuam në fund të vitit 2020 shërbimin në distancë Premium Direct, duke qenë banka e parë në vend që ofrojmë një platformë të përparuar komunikimi e cila gjithashtu ofron mbështetje në aktivitetet e përditshme për kategorinë më të mirë të klientëve tanë.

Segmenti i Ndërmarrjeve të Vogla (SE)

Gjatë vitit 2021 segmenti SE ka patur një performancë shumë të mirë. Volumi i aseteve shënoi një rritje prej 15.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës, duke ruajtur edhe cilësinë e portofolit.

Me dedikimin e të gjithë ekipit, u rrit numri i klientëve dhe veçanërisht baza e klientëve huamarrës me 9%. Fokusi ynë për vitin 2022 do të jetë thjeshtëzimi i mëtejshëm i produkteve dhe shërbimeve si dhe nisja e fushatave për kreditë e para-aprovuara/përzgjedhura, të jemi më fleksibël dhe të përmbushim nevojat e klientëve.

Si pjesë e Raiffeisen Bank International, bankingu i përgjegjshëm, u bë pjesë e strategjisë sonë dhe është një prioritet kyç për Retail. Ne jemi të përkushtuar për një të ardhme të qendrueshme duke ofruar kredi të gjelbra/mjedisore për klientët tanë SME. Përveç kredive të gjelbra/mjedisore, në biznesin SME, kontributi social është i një rëndësie të veçantë.

Segmenti Mikro

Viti 2021 ishte viti i parë i plotë ku modeli i ri i shitjeve dhe shërbimeve Mikro funksionoi plotësisht dhe kjo u reflektua në rezultatet e mira të arritura gjatë këtij viti. Karakteristikat e reja të produkteve dhe veçanërisht fokusi në fushatat e kredive të para-aprovuara/përzgjedhura që u prezantuan ne treg gjatë vitit 2021, ndihmuan në më shumë se dyfishimin e volumit të aseteve në segmentin Mikro dhe në arritjen e një niveli katërfish më të lartë të volumit të disbursimeve të reja.

Jo vetëm në kredidhënie, por edhe në bankungun e përditshëm, u hodhën ne treg paketat e reja të llogarive, të cilat u krijuan posaçërisht me synimin për të plotësuar nevojat e klientëve dhe për të përmirësuar përfitueshmërinë e këtij segmenti. Nëpërmjet paketave të reja, u rrit numri i klientëve të rinj dhe si dhe baza e klientëve që kryejnë transaksione në platformën digjitale, duke përfituar nga dobitë e paketave të krijuara enkas për ta. Gjithashtu në segmentin Mikro, të ardhurat neto nga interesat tejkaluan nivelin e buxhetuar.

Për vitin 2022 fokusi ynë kryesor do të mbetet në aktivitetin kredidhënës. Ne synojmë të sjellim produkte të reja për klientët tanë veçanërisht në industri të tjera ku nuk jemi të shumë aktivë si Agri dhe më e rëndësishmja, do të punojmë drejt digjitalizimit të produkteve të kredisë. Synimi ynë është të vazhdojmë të jemi të pranishëm dhe të mbështesim klientët tanë fizikisht dhe në formë digjitale, bazuar në nevojat e tyre dhe natyrën e tyre të aktivitetit. Përmirësimi i proceseve tona të brendshme për të rritur efikasitetin dhe për të lehtësuar jetën e klientëve tanë, për të promovuar Biznesin e Gjelbër dhe për të mbajtur premtimin tonë për të qenë një bankë e përgjegjshme do të jenë shtytësit tanë kryesorë gjatë vitit 2022.

Divizioni i Produkteve

Depozitat me Afat dhe Produktet e Kursimit

Edhe gjatë vitit 2021, depozitat e klientëve Individë mbetën burimi më i madh i pasiveve të bilancit tonë. Normat e interesit të tregut vazhduan të qendronin në nivele shumë të ulëta gjatë vitit 2021, edhe për shkak të likuiditetit të tepërt në sistemin bankar. Si pasojë, normat e interesit të Depozitave me Afat vazhduan të ishin në nivelet më të ulëta të mundshme. Raiffeisen Bank ishte në gjendje t'u ofronte klientëve opsione alternative për menaxhimin e pasurisë së tyre, përmes shoqërisë sonë të menaxhimit të aseteve, Raiffeisen Invest, shoqëria më e madhe në treg që ofron fonde investimi për publikun. Shumica dërrmuese e klientëve tanë vazhduan të besonin në bankën tonë, duke mbajtur depozitat e tyre pranë nesh, pavarësisht normave të ulëta të interesit. Sidoqoftë, një pjesë e konsiderueshme e bazës sonë të klientëve vendosën të investonin në Fondet e Raiffeisen Invest, duke iu mundësuar të fitonin kthime më të mira vjetore, shumë më lartë se normat e tregut të Depozitave me Afat. Fondet Raiffeisen Invest, të ofruara në të gjithë rrjetin tonë të degëve, gjithashtu tërhoqën klientë të rinj dhe fonde nga burime të tjera. Kombinimi i produkteve tradicionale të kursimeve bankare dhe Fondeve të Investimit të Raiffeisen Invest u dha individëve më shumë zgjedhje dhe mundësi për të rritur kursimet e tyre.

Kreditë për Individë

2021 ishte viti që riformësoi industrinë bankare dhe transformoi çdo pikëpamje të të bërit biznes. Duke lënë pas një vit të vështirë, ku pandemia ndryshoi qoftë jetët tona, qoftë biznesin, ne e filluam vitin me shumë pritshmëri dhe objektiva të qarta për të përmbushur.

Gjatë 2021, kredidhënia për segmentin individ u rrit ndjeshëm. Volumet e reja u rriten me 184% krahasuar me vitin 2020. Kjo rritje u vu re në të gjithë produktet e kredisë për individë, duke na konfirmuar edhe njëherë si lider në kredidhënie dhe pasiguar dhe një pozicion shumë të favorshëm për atë të siguruar në tregun shqiptar.

Në fund të dhjetorit, pjesa e tregut për kreditë e reja të pasiguruara arriti në nivelin 41,28% (29,32% në fund të vitit 2020), ndërkohë që në kreditë e siguruara arritëm të kemi 15,47% (7,97% në fund të vitit 2020).

Pandemia na mësoi të përshtatemi me nevojat e reja të klientëve tanë. Për t'i përmbushur këto, ne u fokusuam në automatizimin e proceseve dhe në digjitalizimin e kredidhënies.

Përvoja dhe përmbushja e kënaqshme e pritshmërive të klientit mbeten fokusi ynë primar dhe ne jemi duke kërkuar vazhdimisht mënyra të reja për të përmirësuar procesin e aplikimit për kredi. Gjatë 2021, hasëm sërish pasiguri për shkak të COVID-19 dhe shumë sfida për të përballuar, por ne vijuam të punojmë vazhdimisht për automatizimin e proceseve dhe digjitalizimin për t'i ofruar klientëve tanë produktet e duhura për ta, edhe ne kushtet e një pandemie globale.

Mënyra e re e të punuarit në organizatë ka dëshmuar tashmë përfitimet e saj. Me metodologjinë Agile, ne jemi në gjendje të mbledhim zërin e klientit, të propozojmë një zgjidhje dhe çfarë është më e rëndësishme, e vërtetojmë atë përsëri me klientët tanë.

Skuadra e kredive të pasiguruara këtë vit u fokusua në lehtësimin e rrugëtimit të klientit për të marrë këtë produkt. Me prezantimin vitin e kaluar të vendimit automatik në kredinë personale, ku kredia miratohet direkt në degë dhe klientët mund të marrin kredinë e tyre me vetëm një vizitë në degë, ne sot mund të themi me bindje të plotë që u kemi përmbushur një premtim klientëve tanë. Ne ofrojmë kredi në 30 minuta. Sot rreth 60% e kredive tona miratohen automatikisht dhe klientët mund të aksesojnë fondet e tyre në 30 minuta.

Kredidhënia digjitale po ashtu ka qenë në fokusin e skuadrës këtë vit. Nënshkrimi elektronik ishte një faktor vendimmarrës në kredidhënie digjitale. Gjatë këtij viti, ne prezantuam në treg 4 produkte tërësisht digjitale për kredinë personale.

Në dhjetor 2021, rreth 29% e kredive të reja erdhën nga kanale digjitale. Ne jemi angazhuar të përmirësojmë eksperiencën e klientëve tanë duke i dhënë atyre mundësinë e marrjes së një kredie personale direkt nga aplikacioni ynë digjital, pa pasur nevojë të paraqiten në degët tona.

Viti 2021 ka qenë një vit sfidues nga pikëpamja e kredihënies së kredive hipotekore, veçanërisht ato me qëllimbletje banesash. Vështirësi ka pasur dhe financimi për kredi konsumatore me hipotekë për shkak të pasigurisë së krijuar në çdo sektor. Pas 2 vitesh tepër të vështira, pandemia e Covid-19, menjëherë pas tërmetit, solli një klimë aspak të favorshme për rezultate në kredihënien e siguruar. Pavarësisht situatës së krijuar, Banka vijoi me kredihënien për klientët për blerje shtëpie, kryesisht me financim kredish nga programe në bashkëpunim me disa Bashki në vend, të cilësua si "Kredi për familje të reja", duke u përpjekur të financojë përfituesit e interesuar. Gjatë 2021 vijoi projekti për kreditë e buta me Ministrinë e Financave, duke sjellë një prurjetë kënaqshme të kredive nga ky program që në muajt e parë, duke ndezur dritën jeshile për vitin në vijim. Paralelishtme këtë, skuadra e kredive të siguruara vijoi diskutimet për ta kthyer situatën e kufizimeve të kredihënies njësoj si para pandemisë.

Fokusi kryesor gjatë 2021 lidhur me kredinë hipotekoreka qenë përmirësimi në procesin e kredihënies së kredive të siguruara, duke pasur në fokus kënaqësinë e klientit. Automatizimi i proceseve të brendshme, ofrimi i lehtësirave për klientin, pranimi i dokumenteve nëpërmjet kanaleve të miratuara elektronike dhe standardizimi i dokumentacionit kanë qenë aktivitetet kryesore të skuadrës. Në fund të 2021, ne arritëm t'i ofrojmë klientit procedim të kredive në kohë rekord për standardet e bankës. Mundëm të nxirrim një vendim për kredinë në 13 ditë dhe të siguronim paratë për llogari të klientit në 16 ditë.

Matja e kënaqësisë së klientit dhe nisma që lidhen me transparencën nga pikëpamja e klientit, promovimi dhe ndërgjegjësimi lidhur me kreditë hipotekorekanë qenë qasjet e përhershme të skuadrës së kredive të siguruara. Duke ofruar në treg një qasje komplet të re për këto produkte, kënaqësia e klientit për këto produkte është në nivele maksimale. Indeksi i klientëve promovues për kredi të siguar në fund të vitit 2021 shënon nivelin 91 nga 100, ndërkohë që kënaqësia e klientëve tanë shënon nivelin 4,86 nga 5.

Në ditët e sotme, bota ka nevojë për ndryshime të qëndrueshme për një të ardhme më të gjelbër. Shoqëritë duhet të punojnë fort për ta arritur këtë.

Raiffeisen Bank Albania është e përkushtuar ndaj bankingut të përgjegjshëm për një të ardhme të qëndrueshme. Kjo është arsyeja pse ne jemi një pionier krenar i bankingut të përgjegjshëm.

Si bankierë të përgjegjshëm, ne mbështesim klientët tanë në Shqipëri me produkte financiare të qëndrueshme dhe njohuri gjithëpërfshirëse.

Në 2021, portofoli ynë i produkteve të gjelbra përfshin katër produkte në përputhje me direktivat ESG: Kredi Ekspres; Kredi për Blerje Shtëpie, Kredi Konsumatore me Hipoteke dhe Kredi e Pasiguar.

Ne jemi përpjekur të ofrojmë produktet më të dobishme të huadhënies, bazuar në praktikat më të mira në këtë industri.

Me anë të këtyre produkteve, ne përqijemi të mbështesim klientët tanë për të financuar aktivitete që kontribuojnë në:

- qytete dhe komunitete të qëndrueshme
- energji të gjelbër
- ndërtesa të gjelbra
- arsim, etj.

Ne i shohim klientët tanë si partnerët më të mirë në këtë rrugëtim. Duke ofruar njohuri për ESG dhe duke rritur ndërgjegjësimin social, ne angazhohemi së bashku për një të ardhme të qëndrueshme.

Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Digjital

Biznesi me karta

Biznesi i kartave njohu një përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë, ndonëse kufizimet e pandemisë Covid 19 ishin ende të pranishme. Digjitalizimi i produkteve të kartave, debitit dhe kreditit ishte një nga strategjitë kryesore ku Raiffeisen Bank Albania është fokusuar vazhdimisht për të ofruar përvojën më të mirë si përdorues për klientët tanë. Prandaj, gjatë vitit 2021 kemi prezantuar Aplikacionin Online për Kartë Debiti dhe Produkte e kredisë. Ky kanal i ri digjital është shumë i lehtë, i përshtatshëm dhe miqësor për përdoruesit u dedikua për klientët tanë.

Mbajtësit e kartave RBAL vazhduan të kërkonin dhe të aplikojnë për instrumentin Inteligjent të pagesës pa kontakt dhe ne u përballëm me një rritje të konsiderueshme të shitjeve me pothuajse 4 herë më shumë kundrejt vitit 2020 për produktin e kartës së kreditit. Përdorimi i kësaj pajisjeje inteligjente dëshmoi të ishte shumë më i lartë, me gati 7 herë më shumë për këtë produkt dhe kjo performancë rikonfirmoi se RBAL është ende lider në treg në inovacion dhe produktet tona të reja janë përqafuar shumë mirë nga klientët tanë.

Rezultatet e biznesit të kartave të vitit 2021 tregojnë qartë tendencën në rritje të viteve të fundit, veçanërisht për produktet e Kartës së Debitit që kryejnë transaksione përmes POS-ve. Pothuajse 20% më shumë volum transaksionesh

me Kartën e Debitit të kryera gjatë vitit 2021 kundrejt vitit 2020, por kjo rritje është +55% në transaksionet me POS, gjë që dëshmon rezultatet e mira të strategjisë së bankës për digjitalizimin e shërbimeve dhe kalimin e transaksioneve nga cash në ato në POS. Rezultate shumë të mira janë shënuar edhe për portofolin e kartave të kreditit. +41% më shumë volum transaksionesh janë kryer gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2020 me kartë krediti dhe kryesisht nëpërmjet pajisjeve POS.

Ofrimi i përvojës më të mirë të klientit për mbajtësit e kartave tona ishte në fokusin e bankës. Zbatimi i një mënyre të re, të shpejtë, të përshtatshme dhe të sigurt të dërgimit të PIN-it përmes SMS për mbajtësit e kartave ishte një nga investimet e realizuara me sukses gjatë vitit 2021 dhe e hedhur në treg për mbajtësit e kartës së debitit dhe kreditit.

Rrjeti i POS

Gjatë vitit 2021, Banka Raiffeisen vazhdoi të fokusohet në zgjerimin e përdorimit të POS dhe përfitimit që rrjedh prej tij, duke forcuar kryesisht prezencën në kategorinë e tregtarëve të mëdhenj dhe të mesëm, por edhe duke zgjeruar portofolin e segmentit mikro. +80% tregtarë të rinj përfaquan përdorimin gjatë 2021 krahasuar me 2020 duke arritur kështu +32% rritje të portofolit të tregtarëve POS.

Rezultatet e të dhënave të transaksioneve POS të vitit 2021 konfirmuan një rritje të ndjeshme dyshifrore prej 53% në vëllimet e kryera përmes rrjetit tonë POS. Është e rëndësishme të përmendet se kufizimet pandemike kanë ndikuar në sjelljen e përdorimit të POS të klientëve në krahasim me transaksionet me para në dorë.

Tregtia Elektronike

Të kesh në fokus strategjinë e digjitalizimit, me fokus për Raiffeisen Bank Albania, nënkupton ofrimin e kanaleve digjitale për transaksionet e pagesave të klientëve. Në këtë mënyrë, ne zgjerojmë portofolin e tregtisë elektronike me +64% në 2021 kundrejt vitit 2020. Raiffeisen Bank bën investime të konsiderueshme për të ofruar standardin më të avancuar të sigurisë së pagesave për procesin e blerjes në internet nëpërmjet Teknologjisë 3-D Secure. Raiffeisen Bank mbetet lider i tregut për shërbimin e tregtisë elektronike në tregun shqiptar me një rritje prej 52% të vëllimit të transaksioneve kundrejt vitit 2020.

Rrjeti i ATM

Raiffeisen Bank ruan bindshëm pozicionin lider në treg me rrjetin më të madh të ATM-ve në vend. Rrjeti i ATM-ve është duke u optimizuar vazhdimisht për t'iu shërbyer më mirë nevojave të klientëve tanë, duke marrë parasysh kërkesat e larta të klientëve veçanërisht në vendndodhjet me trafik më të lartë. Shërbimi ATM ofrohet për të gjitha kartat e lëshuara globalisht nën markat VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus.

Funksionaliteti Cash-In (depozitimi i parave cash) ka qenë një shërbim shumë i suksesshëm gjatë vitit 2021 me një rritje të fortë prej +158% të vëllimit të transaksioneve nga viti në vit dhe më shumë se dyfish në numrat e transaksioneve. Tani ka 96 ATM në të gjithë vendin që u mundësojnë klientëve tanë të depozitojnë 24/7 në llogaritë e tyre pa pasur nevojë të vizitojnë fizikisht një degë.

Përmirësimi i funksioneve digjitale të ATM-ve është pjesë e ekosistemit bankar në shumë kanale të Raiffeisen Bank, duke synuar rritjen e disponueshmërisë dhe përdorimit të kanaleve bankare digjitale 24/7 në rrjetin tonë të ATM-ve dhe në qendrat e vetë-shërbimit. Transaksionet pa kontakt të kryera nëpërmjet ATM-ve RBAL janë një avantazh në tregun shqiptar i zbatuar gjatë vitit 2021 dhe i përfaqëuar shumë mirë nga klientët tanë.

Bankingu Digjital

Raiffeisen Bank Albania i ka dhënë përparësi kryesore digjitalizimit dhe për të arritur këtë, ka hartuar një strategji ambicioze për të shndërruar përvojën bankare të klientit, duke ofruar një dimension digjital shumëdimensional.

Ndërsa teknologjia po fiton rëndësi në çdo aspekt të jetës së klientëve tanë, Raiffeisen Bank ishte e para në treg që njohu urgjencën e menjëhershme për të digjitalizuar produktet dhe shërbimet e saj, me qëllimin për t'iu ofruar klientëve të saj shërbime me qasje të përshtatshme, duke i lejuar ata të veprojnë me lehtësi dhe pa pengesa në platformën digjitale, pavarësisht se cilin kanal përdorin si kompjuter, laptop, celular, e deri te ATM dhe Termialet e Vetë-Shërbimit.

Viti 2021 vazhdoi si vit i vështirë për shkak të rasteve të reja të COVID, ndërkohë që shumë njerëz po rrisnin kërkesën për shërbime online dhe këshillim në distancë, pa prezencë fizike.

Gjatë vitit 2021, Raiffeisen Albania ishte banka e parë në Shqipëri që ofroi shërbimin Premium Direct nëpërmjet platformës RaiConnect. Unik në tregun tonë, RaiConnect është një mënyrë e re dhe e sigurt për të komunikuar në internet. Klientët tanë Premium mund të: flasin, shkëmbejnë dokumente, të kryejnë takime me punonjës të bankës, duke vendosur një komunikim interaktiv. Për më tepër, përmes RaiConnect, klientët Premium mund të marrin këshillim për planet dhe investimet e tyre financiare, sa herë që janë në distancë. Synimi është zgjerimi i këtij shërbimi për më

shumë klientë dhe, në të njëjtën kohë, zhvillimi i përvojës më të mirë të klientit duke ofruar produkte 'end-to-end' së shpejti.

Ne ishim të angazhuar për të krijuar një eksperiencë gjithëpërfshirëse digjitale për klientët e rinj, duke konsideruar që duhet ta ofronim këtë eksperiencë edhe me cilësi, dhe duke respektuar kuadrin ligjor dhe duke përfaqësuar Bankën e parë në vend që ofron këtë lloj shërbimi. Të gjitha këto sfida frymëzuan skuadrën tonë të dedikuar digjitale ta ndërmarin këtë nismë.

Procesi dhe eksperiencia digjitale e klientëve të rinj është e thjeshtë, ku në më pak se 15 minuta klientët mund të përfundojnë procesin e hapjes së llogarisë nga shtëpia/vendndodhja e tyre, ku mbizotëron kriteri i sigurisë për të qenë i mbrojtur nga kontakti fizik me njerëzit. Në bashkëpunim me partnerin tonë Evrotrust, i cili mbulon shërbimin e firmës elektronike në këtë proces, ne arritëm të tejkalonim sfidat ligjore në lidhje me identifikimin dhe nënshkrimin e dokumenteve në distancë.

Ne nuk u kufizuar vetëm në angazhimin e klientit për hapjen e një llogarie online, por gjithashtu ofrimin e një mundësie për të aplikuar për një produkt kryesor si kredi personale, kartë debiti apo kredi dhe në të ardhmen produkte të tjera, për t'i dhënë një shtysë thelbësore shitjes së produkteve bankare online.

Duke ndjekur edhe tendencat më të fundit të aplikacioneve financiare dhe si lider në treg për inovacionin e shërbimeve bankare, ofrimi i funksionaliteteve të tjera si:

- Aplikimi për kartë debiti nga aplikacioni Digjital dhe faqja zyrtare e internetit

Në platformën Raiffeisen On:

- Aplikim për kartë krediti të miratuar paraprakisht
- Aplikim për kredi personale për kategori pagamarrës dhe jo-pagamarrës
- Kërkesë për para në "Kuik"
- Hyrje në aplikacion me "Fingerprint" apo "Face ID"
- Blerja e kuotave të fondeve të investimit për investitorët ekzistues
- Këmbimet valutore preferenciale u ofruan me një dizajn të ri dhe miqësor për klientin
- "Shpenzimet e mia" për më shumë kontroll dhe detaje në lidhje me shpenzimet e klientit.

Digjitalizimi përveçse kërkesë dhe domosdoshmëri, është edhe një diferencues në treg në mënyrë që të mbajmë ritmin e bankave direkte digjitale dhe të përqafojmë e edukojmë tendenca të reja.

Gjatë vitit 2021, numri i klientëve që janë pjesë e platformës Raiffeisen ON arriti në 58% të totalit të individëve aktivë. Është e rëndësishme të përmendet penetrimi i bankngut celular në 30,2% të totalit të individëve aktivë. Për herë të parë, përqindja e kredive digjitale arriti 13% në platformën dhe faqen e internetit Raiffeisen On, që ishte një tjetër histori suksesi që sapo filloi.

Jemi të përkushtuar që në vitet e ardhshme të ketë më shumë shitje digjitale për produkte dhe shërbime të ndryshme. Transformimi digjital në bankën tonë do t'i ndihmojë klientët të afrohen me gjeneratat dhe të rinjtë e mijëvjeçarit, të cilët janë edhe më të aftë në lidhje me teknologjinë.

Pagesat

Numri i transaksioneve të pagesave të kryera nëpërmjet platformës digjitale Raiffeisen ON vijon të rritet me ritme të shpejta. Situata pas pandemisë ka "mësuar" klientët që çdo ditë e më shumë të shmangin radhët në degë dhe t'u drejtohen platformave online si Raiffeisen ON Mobile dhe WEB. Transfertat e klientëve Individë nëpërmjet Raiffeisen ON janë rritur me 135% në krahasim me vitin 2020. Përmirësime të tjera në procese janë kryer për t'u përshtatur më mirë ndryshimeve të shpejta nga situata e pandemisë së Covid-19, si dhe për t'ua bërë klientëve sa më të thjeshtë aktivitetin e tyre me bankën.

Bancassurance

Në datën 31.10.2016, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare licencoi Raiffeisen Bank për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e Jetës dhe të Jo-Jetës. Raiffeisen Bank ishte banka e parë në treg e licencuar si Broker në Sigurime. Nëpërmjet stafit të bankës të licencuar si broker fizik kryhet veprimtaria e brokerimit në sigurime, në emër dhe për llogari të Raiffeisen Bank.

Duke përdorur rrjetin ekzistues të degëve dhe forcën aktuale shitëse, aktiviteti i brokerimit për produktet e sigurimit, që filloi të zhvillohet në kuadër të kësaj licencë, kontribuon në vijimësi në uljen e riskut për portofolin e kredive të siguruar dhe të pasiguruara, si dhe në rritjen e të ardhurave nga komisionet për segmentin Individë duke kontribuar mbi 12% të total të ardhurave nga komisionet gjatë 2021. Të ardhurat nga aktiviteti i brokerimit në vitin 2021 u rritën me 161% krahasuar me 2020 ose 20% krahasuar me 2019 meqë gjatë 2020 vuajtëm edhe pasojat e pandemisë Covid-19.

Eksperienca e klientit

Banka ka qenë në transformim të vazhdueshëm vitet e fundit, me fokus zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve inovatore, si dhe ofrimin e kanaleve të reja të shërbimit.

Për ne, vëmendja ndaj klientëve dhe adresimi i nevojave të tyre, është një nga detyrat primare. Përgjatë 2021, shqetësimet dhe sugjerimet e klientëve, janë mbledhur rregullisht nëpërmjet 3 shtyllave për mbledhjen e zërit të klientëve: NPS për veprimtarinë e përditshme, Sugjerime dhe Ankesa. Këto, janë ndarë brenda organizatës në mënyrë aktive, për të rritur ndërgjegjësimin ndaj shërbimit të klientëve.

Ne jemi ndër të paktat banka në treg që ofrojmë mbështetje online 24/7, nëpërmjet Asistentes Virtuale RONA, duke zëvendësuar kështu kanalet tradicionale të komunikimit, me kanale më inovatore. Vetëm gjatë 2021, RONA ka patur rreth 268,000 ndërveprime me klientë, nëpërmjet kanaleve të ndryshme si faqja zyrtare e bankës, Messenger, WhatsApp, dhe Viber.

Krijimi i një kulture me në qendër klientin, është thelbësor për përbushjen e misionit tonë. Për këtë, gjatë 2021, rreth 21% e punonjësve të bankës, në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Degë, kanë marrë pjesë në trajnimin e Eksperiencës së Klientëve, në një modul të veçantë të krijuar enkas për Grupin RBI.

Menaxhimi i marrëdhënies me klientin – CRM

Zhvillimet në CRM, përgjatë vitit 2021, shënuan një hap të rëndësishëm në ndërtimin e platformave bashkëkohore, të integruara me shumë kanale digjitale komunikimi. Tashmë, klientët tanë nuk kanë nevojë të kërkojnë mënyra alternative për të komunikuar me bankën, ne sigurohemi që të mund t'i adresojmë nevojat e klientëve nëpërmjet kanaleve digjitale që ata përdorin më shumë në jetën e tyre të përditshme.

Qëllimi ynë ndër vite ka qenë fokusimi në nevojat e klientëve dhe ofrimi i shërbimeve të duhura në kohën e duhur.

Shërbimet tona më të reja, mundësojnë që nëpërmjet komunikimeve digjitale, klientët të jenë në dijeni në mënyrë frekvente, për sjelljen e tyre financiare, si dhe t'u ofrojmë ide se si mund të arrijnë qëllimet e tyre, ose të marrin vendime më të mira financiare.

Qendra e Kontaktit

Qendra e Kontaktit të Raiffeisen Bank zhvillon aktivitetin e saj të fokusuar në dy drejtime kryesore; shqyrtimin e kërkesave të klientëve nëpërmjet telefonatave hyrëse dhe kanaleve të tjera alternative si email, Chatbot, mediat sociale, Evrotrust dhe kanalin elektronik Raiffeisen ON; zhvillimin e fushatave telemarketing/informuese/pyetësore për produktet dhe shërbimet e bankës.

Qendra e Kontaktit ofron shërbim 24 orë në 7 ditë, duke siguruar informacion mbi produktet dhe shërbimet e bankës, sipas nevojave të klientëve të identifikuar nëpërmjet telefonatave dhe kanaleve të tjera alternative të komunikimit. Kjo njësi ofron asistencë për të gjitha produktet dhe shërbimet e bankës, ku mund të përmendim kartat e debitit dhe kreditit, kreditë, shërbimet e POS & e-Commerce, ATM, kanalet elektronike si: Mobile Banking/ Internet Banking si dhe autentifikimin e klientëve për të drejtën e nënshkrimit digjital nëpërmjet Evrotrust dhe shërbimit online për klientët e rinj në MyRaiffeisen.al.

Qendra e Kontaktit luan një rol shumë të rëndësishëm në aktivitetin monitorues për produktet e kartave dhe bankingut digjital, duke ndihmuar në parandalimin e rasteve të mashtrimit. Gjatë vitit 2021, Qendra e Kontaktit ka ofruar shërbim 24/7 për të gjithë klientët e bankës, kryesisht individë dhe biznese të vogla dhe të mesme, duke qenë një pikë e rëndësishme kontakti në të gjitha kanalet e komunikimit. Stafi i Qendrës së Kontaktit ka trajtuar rreth 156 000 kërkesa të klientëve dhe u ka ofruar atyre një shërbim shumë të mirë në lidhje me kartat, kanalet digjitale dhe produktet e shërbimit e reja të bankës. Gjithashtu, bazuar në strategjinë e CRM-së, njësia e Telemarketing kontakton klientët e përzgjedhur, nëpërmjet telefonit, për oferta të dedikuara që janë pjesë e menaxhimit të marrëdhënieve me klientët e bankës. Gjatë vitit 2021, janë kryer rreth 124 fushata me një total prej 176 161 klientë të synuar ose rreth 13 përqind më shumë në krahasim me vitin 2020. Objektivat kryesore të Qendrës së Kontaktit janë ofrimi i zgjidhjeve në një kohë të shkurtër për kërkesat e klientëve tanë, duke përmirësuar cilësinë e shërbimit dhe të sigurojë shitje dhe të ardhura të reja, ndërsa rrjedhimisht rrit bazën e klientëve!

Kanalet e Shitjes dhe Shpërndarjes - 2021

Raiffeisen Bank vazhdon të jetë lider në treg me rrjetin më të madh të degëve në Shqipëri, 74 degë dhe agjenci të shpërndara në 43 qytete, duke mbuluar pjesën më të madhe të vendit. Rrjeti i degëve mbështetet nga 24 Zona të Vetë-Shërbimit të bashkëngjitura në degët kryesore të pajisura me ATM derdhje/tërheqje, 5 më shumë krahasuar me një vit më parë.

17 degë në të gjithë vendin kanë një kënd Premium, ku një menaxher i dedikuar për klientët Premium, ofron këshillim dhe shërbime për klientët Premium në një hapësirë private të dedikuar vetëm për këtë grup klientësh. Shërbimi Premium Direct, nëpërmjet aplikacionit RaiConnect, vazhdon të zgjerohet si një kanal, i krijuar për komunikim shtesë, duke ofruar këshillim dhe shërbime në distancë për klientët Premium të bankës.

Ruajtja e standardeve të larta në të gjitha pikat bankare nëpërmjet investimeve ka vazhduar të jetë një shtyllë kryesore e bankës për të ofruar hapësirë komode shërbimi dhe privatësi për klientët. Gjatë vitit 2021, u përfunduan disa projekte zhvillimore të degëve. Raiffeisen Bank vijon të investojë në rrjetin e degëve që të ofrojë një shërbim superior ndaj klientit.

Gjatë vitit 2021, Raiffeisen Bank ka zgjeruar në 6 degë të tjera konceptin e bankingut digjital (pa Cash), duke e rritur numrin nga 2 në 8. Degët digjitale, të pajisura me tableta, ofrojnë të gjithë shumëllojshmërinë e produkteve dhe shërbimeve bankare, me përjashtim të shërbimit cash, i cili ofrohet përmes ATM-ve. Stafit është fokusuar në edukimin digjital të klientëve, duke i nxitur ata drejt përdorimit të platformës digjitale, si dhe duke u dëshmuar atyre përdorimin që të kryejnë transaksione në kanalet digjitale dhe në ATM. Koncepti hibrid i degës, prezantuar gjatë vitit 2021, është një kombinim i degës standarde dhe digjitale, me orë të reduktuara të shërbimit cash dhe fokus të shtuar në shitjet dhe edukimin digjital të klientëve.

Të gjitha degët tona janë pajisur me shërbim Wi-Fi falas për klientët në kuadër të digjitalizimit të proceseve bankare, duke u shërbyer klientëve për përdorimin e kanaleve digjitale bankare. Klientët mund të shkarkojnë platformën Raiffeisen ON për një eksperiencë më të shpejtë bankare si dhe aplikacionin My Raiffeisen për hapjen e një llogarie të re bankare.

Raiffeisen Bank vazhdon bashkëpunimin e suksesshëm me Postën Shqiptare për transaksionet e depozitimeve kesh. Një zyrë e re postare është shtuar në listën e zyrave postare që ofrojnë depozitime bankare cash për klientët tanë, duke arritur në 31 zyra postare në të gjithë vendin ku banka nuk është e pranishme.

Trajnimi i stafit të degëve ka qenë në fokus të vazhdueshëm gjatë 2021, bazuar në nevojat e identifikuar në Matricën e Aftësive, prioritetet e bankës për digjitalizimin dhe kredidhënien. U ofrua paketa e trajnimit për Digjitalizimin, për rritjen e ndërgjegjësimit mbi zhvillimet digjitale dhe risitë. Stafit i shitjes u trajnua mbi kredidhënien për klientët Mikro, ndërkohë që menaxheret e marrëdhënieve Premium nisën të afronin klientët Mikro në bankingun e përditshëm.

Të punuarit Agile në degë u pilotua me sukses si një risi në Shqipëri, me rezultate dhe opinion shumë të mirë nga ana e stafit.

Raiffeisen Bank është banka më e madhe që ofron shërbimin për financimin e shpejtë pranë dyqaneve Retail, duke qenë prezent në 33 vendndodhje, deri në fund të vitit 2021. 5 vendndodhje të reja dhe 4 pika të reja shitjeje në vendndodhjet ekzistuese (kryesisht mobilieri dhe shërbime) janë shtuar për klientët tanë, duke rritur përfitimet që ata marrin, të kombinuar me shërbimin e standardit më të lartë.

Thesari dhe Bankingu i Investimeve

Të Ardhurat Fikse

Viti 2021 ishte një vit pasigurie, pritshmërie dhe shprese për rikthim në normalitet pas fillimit të pandemisë së COVID-19 në vitin 2020. Ishte një vit që dëshmoi përsëri vështirësitë që shoqërojnë marrjen e vendimeve për investime, bazuar në parashikimet se në çfarë drejtimi do të shkojnë tregjet.

Pas daljes nga një 2020 e paqëndrueshme, investitorët ishin në kërkim të sinjaleve se në cilin drejtim po shkonte ekonomia globale. Rritja e niveleve të vaksinimit dhe lehtësimi i kufizimeve që lidheshin me pandeminë, u pasuan nga një përmirësim i situatës ekonomike, por shfaqja e varianteve të reja solli sfida të reja për rimëkëmbjen e ekonomisë. Pavarësisht këtyre sfidave, ekonomia shqiptare u përmirësua ndjeshëm gjatë vitit 2021, duke treguar shenja të tranzicionit nga rimëkëmbja në tejkalimin e shifrave të saj para pandemisë. Megjithatë, rimëkëmbja u shoqërua me rënie të fuqisë punëtore, probleme në zinxhirin e furnizimit dhe rritje të inflacionit. Norma vjetore e inflacionit arriti në vlerën e 3,7 përqind në fund të vitit, duke shënuar nivelin më të lartë të dekadës së fundit.

Politika monetare ka vijuar të mbetet në kahun lehtësues gjatë të gjithë vitit, e përcjellë përmes nivelit më të ulët historik të normës bazë së të interesit, normë e cila është mbajtur e pandryshuar në nivelin 0,50 për qind dhe përmes rritjes së injektimit të likuiditetit në sistem, në përpjekje për të ofruar stimujt e nevojshëm për nxitjen e rritjes ekonomike dhe mbajtjen nën kontroll të inflacionit.

Si rezultat, viti 2021 u karakterizua nga një rënie në normat e interesit për letrat me vlerë në të gjitha maturitetet, gjë që pati efekt në performancën e portofolit tonë gjatë këtij viti dhe në strategjinë tonë të investimeve për periudhën në fjalë.

Pavarësisht të gjitha sfidave të hasura gjatë këtij viti, portofoli ynë i investimeve ka ndjekur strategjinë e përgjithshme të grupit për të qenë në përputhje me rregullatorët financiarë të Bashkimit Evropian dhe kërkesat e tyre. Trajtimi i aktiveve të ponderuara me rrezik ka qenë në fokus, duke ndikuar objektivat tona për investimet me të ardhura fikse. Qëllimi ynë kryesor ka qenë ruajtja e qendrueshmërisë së nivelit të investimeve, duke qenë gjithmonë në përputhje me çdo rregullator vendor dhe Evropian. Struktura e portofolit tonë pësoi disa ndryshime gjatë vitit 2021, pasi ne mundëm të rrisim investimet në obligacione në monedhë të huaj, duke përfituar nga hapësira që na krijoi garancia e BERZH-it, dhe gjithashtu në këtë periudhë ne u përqendruam veçanërisht në investime në letra me vlerë me maturim 2 deri në 3 vjet.

Gjatë këtij viti, banka jonë ka vijuar të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të tregut dytësor të titujve të qeverisë shqiptare, duke rritur volumet e tregtuara brenda bankave. Pjesëmarrja në ankandet standard (benchmark) me maturitet 3 dhe 5 vjet është ekskluzive për krijuesit e tregut, megjithatë edhe pse ne nuk jemi ende pjesë e panelit, këto investime zënë një pjesë të konsiderueshme të portofolit tonë dhe ne i tregtojmë ato në mënyrë të vazhdueshme në tregun sekondar në mënyrë që ta pasurojmë dhe diversifikojmë atë më tej, por gjithashtu edhe për të kontribuar në zhvillimin e një tregu sekondar të mirëkonsoliduar në vendin tonë.

Ky vit u karakterizua nga paqëndrueshmëri e lartë në normat e interesit për të gjithë llojet e investimeve. Normat filluan të ulen ndjeshëm në tremujorin e tretë të vitit, për të arritur pikën më të ulët në tremujorin e fundit të vitit 2021. Luhatjet e konsiderueshme në normat e interesit dhe tendenca në rënie në gjysmën e dytë të vitit në të gjitha maturitetet u ndikua nga niveli i lartë i likuiditetit në tregun vendas dhe mungesa e alternativave të investimeve të tepricës së monedhës vendase.

Gjatë gjithë vitit 2021, ne kemi qenë shumë aktivë në tregun sekondar si dhe të shitjes me pakicë të klientët individë, veçanërisht në ankandet e drejtpërdrejta, me banka dhe institucione financiare vendase dhe ndërkombëtare, duke gjeneruar fitim të lartë nga tregtimi në atë treg. RBAL edhe gjatë këtij viti ka ofruar shërbimin e kujdestarisë për klientët e saj.

Tregu i Parasë

Njësia e Tregut të Parasë si pjesë e rëndësishme e Dhomës së Transaksioneve në departamentin e Thesarit ka luajtur një rol aktiv në objektivin e RWA të Bankës për vitin 2021, duke përdorur instrumente të ndryshme për ruajtjen e rezervës minimale të detyruar në Bankën Qendrore. Njësia ka kontribuar në vazhdimësi për ruajtjen e raportit të likuiditetit në nivelin e kërkuar sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Portofoli i Tregut të Parasë gjatë gjithë vitit 2021 është menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe janë përdorur maturime të tilla që kanë respektuar të gjitha kufizimet e vendosura, duke siguruar dhe përbushur në çdo moment nevojat e bankës dhe klientëve të bankës për likuiditet në çdo monedhë.

Kjo njësi ka kontribuar në administrimin afatshkurtër të likuiditetit, duke rritur numrin e transaksioneve ndërbankare, në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare, si dhe duke zhvilluar më tej aktivitetin ndërbankar duke përdorur instrumente të ndryshëm.

Pavarësisht përpjekjeve të vogla të tregjeve për rimëkëmbje gjatë vitit 2021, në një mjedis të vazhdueshëm me norma të ulëta interesi, Njësia e Tregut të Parasë ka bërë përpjekjet maksimale për të menaxhuar me sukses likuiditetin afatshkurtër dhe për të arritur një performancë të mirë.

Krahas aktivitetit të zakonshëm kredihënës, gjatë vitit 2021, një pjesë e likuiditetit tonë është investuar në titujt shtetërore në tregjet ndërkombëtare, si një alternativë investimi tërheqëse me normën më të mirë të kthimit.


Si pjesë aktive dhe e nevojshme e një tregu lokal ende në zhvillim, Njësia e Tregut të Parasë vazhdoi të kontribuonte çdo ditë për botimet TRIBID / TRIBOR. Këto kuota janë një aspekt shumë i rëndësishëm i zhvillimit të tregut vendor, duke reflektuar aktivitetin e tij dhe TRIBID/TRIBOR, dhe janë gjithashtu një çështje e rëndësishme në parashikimin dhe interpretimin e situatave të tregut.

Njësia e Tregut të Parasë jep vazhdimisht kontributin e saj, në mënyrë që të ketë ndikime të mëtejshme në zhvillimin e tregut, instrumentet dhe mundësitë e investimit në afat të shkurtër.

Këmbimi Valutor

Edhe ky vit që kaloi ishte një vit pasigurie, parashikimi dhe shpresash për një kthim në një shkallë normaliteti pas fillimit të pandemisë COVID-19 në 2020. Ishte një vit që tregoi përsëri vështirësinë e marrjes së vendimeve për investime bazuar në parashikime se ku do të shkojnë tregjet. Duke dalë nga një 2020 e paqëndrueshme, edhe këtë vit që e vështirë të identifikohet se në cilin drejtim po shkonte ekonomia globale. Shpërndarja e vaksinave dhe lehtësimi i bllokimeve u pasuan nga një rikthim ekonomik, por shfaqja e varianteve të reja ishte përsëri një pengesë për rimëkëmbjen. Pavarësisht këtyre sfidave, produkti i brendshëm bruto global u rrit, duke përfunduar tranzicionin nga rimëkëmbja në zgjerim dhe përfundimisht duke tejkaluar kulmin e tij para pandemisë.

Në tregun vendas, në gjysmën e parë të vitit 2021 situata ka qenë më e qëndrueshme. Luhatjet kanë qenë shumë të vogla si rrjedhojë e një kërkese/oferte të balancuar për monedhën Evropiane. Ndërkohë, gjatë gjysmës së dytë të vitit, shohim një dobësim të lekur kundrejt monedhës Evropiane. Dobësimi i lekur ka ardhur si rrjedhojë e të gjitha arsyeve që përmendëm më sipër në lidhje me pasigurinë e së ardhmes ekonomike të vendit, nga politikat e ndryshme që ndiqnin vendet për menaxhimin e pandemisë si dhe nga politikat monetare të ndjekura nga FED dhe ECB etj. Gjithsesi, gjysma e dytë e vitit ka qenë më e qëndrueshme, tregjet kanë qenë më optimiste për një periudhë në rritje, pasi vaksinat janë shpërndarë gjerësisht dhe ekonomia po rihapet plotësisht.



Edhe pse një vit me shumë luhatje në tregun valutor vendas, Njësia e Këmbimeve Valutore ka menaxhuar me kujdes pozicionin valutor dhe të gjitha rreziqet që lidhen me të. Kjo është arritur duke u bazuar në analiza profesionale të tregjeve financiare, duke e mbyllur vitin me rezultate shumë të mira.

Dollari Amerikan ka ndjekur të njëjtin trend si në tregun ndërkombëtar, por më tepër është ndikuar nga teprica e likuiditetit në valutën e tregun vendas. Njësia e Këmbimit Valutor ka dhënë mbështetjen e saj maksimale në tregun lokal, me mbajtjen e një kuotimi konkurrues në ofertë/kërkese në tregun ndërbankar dhe me klientët.

Volumet e veprimeve të këmbimit valutor kanë vazhduar të jenë të larta veçanërisht në veprimet EUR/USD në nivelet e 190 milionë euro në muaj. Në këtë sukses, një ndikim të madh ka pasur dhe platforma digjitale ku, nëpërmjet së cilës, në këtë periudhë pandemie janë kryer rreth 80% e transaksione me këmbim për klientët.

Njësia e Shitjeve

Nisur nga suksesi i përdorimit të shërbimeve online për produktet e thesarit dhe kërkesat në rritje nga klientët, kemi arritur të shtojmë shërbimet e ofruara nëpërmjet platformës digjitale dhe të rrisim cilësinë e këtyre shërbimeve. Gati 85% e shërbimeve të thesarit kryhen nga klientët nëpërmjet platformës online, duke optimizuar në maksimum kohën e klientëve si dhe në përfitimin e çmimeve më të mira. Edhe pse 2021, ishte përsëri një vit i vështirë përsëri në pandemi, Njësia e Shitjes së Thesarit e mbylli me rezultate të larta. Në fokus të tyre qendrongjithmonë përmbushja e nevojave të klientëve në përputhje me politikat dhe strategjitë e bankës. Ky vit i vështirë e dëshmoi në mënyrën më të mirë të mundshme, duke treguar se sa të orientuar jemi në kundërt kërkesave të klientëve, për t'u ofruar të gjitha kanalet e mundshme ku ata mund të plotësojnë kërkesat e tyre me çmimet më të mira në treg. Stafi ynë i dedikuar, profesional dhe bashkëpunues, së bashku me të gjitha kanalet e biznesit të Raiffeisen Bank, luajtën një rol kyç në arritjen e këtij qëllimi.

Departamenti i Shitjeve të Thesarit vazhdon të jetë lider në tregun financiar shqiptar, duke ofruar çmimet më konkurruese në treg.

Përgjegjësia Sociale e Korporatës

Raiffeisen Bank në Shqipëri ka një histori të gjatë dhe kulturë korporate të fortë në mbështetjen e zhvillimit të qendrueshëm. Gjatë vitit 2021 vazhduam të tregojmë angazhimin tonë në mbështetjen e problemeve sociale, promovimin e jetës kulturore dhe mbrojtjen e mjedisit. Ne besojmë fort se duke kombinuar biznesin me investimin në shoqëri dhe dëshirën për të sjellë një ndikim pozitiv po kontibuojmë në mirëqenien afatgjatë të komunitetit dhe në ndërtimin e një të ardhmeje të begatë për të gjithë.

Përgjatë vitit 2021 kemi mbështetur mbi 65 projekte në fusha të ndryshme.

Edukimi i brezave të rinj, veçanërisht ai financiar, ishte një fushë ku vëmendja jonë ishte veçanërisht e dedikuar përgjatë vitit që lamë pas. Realizuam 11 projekte për edukimin, gjithëpërfshirjen dhe arsimimin e barabartë. Ndër projektet, do të veçonim mbështetjen e dy qendrave sociale ditore në bashkëpunim me fondacionin "H. Stepic CEE Charity", ku marrin mësim mbi 200 fëmijë nga shtresat e marginalizuara. Për të dytin vit me radhë mbështetëm Institutin e Nxënësve që nuk shikojnë me pajisje kompjuterike. Ofruam 150 bursa në qendrën Inovatore Tumo për fëmijët e shtresave të nevojshme. "Edukimi Financiar në epokën digjitale" dhe "Njihuni me paranë" ishin dy projekte ku u trajnuan mbi mbi 400 nxënës të disa shkollave në Tiranë.

Një vëmendje të veçantë i kushtuam sektorit të shëndetësisë, si një prej sektorëve më të rëndësishëm duke mbështetur disa projekte, si pajisja e spitalit Shkodër me një aparat urë echo, instalimi i sistemit të ngrohjes në spitalin Sarandë dhe pajisjen me disa aparatura të Maternitetit të spitalit Lezhë.

Kontributi i Raiffeisen Bank në rehabilitimin e ambientit ku jetojmë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës ka qenë i konsiderueshëm dhe konsistent. Këtu përmendim 19 projekte, duke veçuar rehabilitimin e një këndi rekreativ në lagjen nr.4 në qytetin e Sarandës, pajisjen kopshtit Nr.1 në qytetin e Kukësit me 165 krevate si edhe dhurimin e 250 pakove me ushqime për familjet në nevojë me rastin e festave të fundvitit.

Mbrojtja e mjedisit dhe rritja e sensibilizimit në këtë drejtim ka qenë një tjetër sferë ku kemi lënë gjurmën tonë. Është pastruar mbi 10 km vijë bregdetare në 4 zona bregdetare, Durrës, Vlorë, Lezhë dhe Shkodër falë kontributit të mbi 200 vullnetarëve dhe stafit të bankës, me qëllim jo vetëm pastrimin, por edhe nxitjen e vullnetarizmit si formë veprimi dhe edukimi qytetar e mjedisor.

Arti dhe kultura si një pjesë thelbësore e emancipimit të një shoqërie, u promovuan nga banka me anë të kontributit të dhënë për realizimin e një sërë projektesh në këtë fushë. Ndër më të rëndësishmit do të veçonim mbështetjen e Teatrit Kombëtar në kalendarin artistik të vitit, mbështetjen e kalendarit artistik të Teatrit të Kukullave, sponsorizimin e edicionit të 10-tëtë koncertit "Tre tenorët", Zâ Fest, etj.

Projekte të tjera të rëndësishme që përkrahin turizmin apo jetesën e shëndetshme përmes sporteve ishin "South Outdoor Festival", "Maratona e Tiranës", "Voskopja Trails", etj.

Raiffeisen Bank e konsideron shumë të rëndësishme Përgjegjësinë Sociale të Korporatës dhe si e tillë do të mbetet e përkushtuar për të dhënë kontributin e saj për t'u bërë pioniere e zhvillimit të qendrueshëm të shoqërisë në Shqipëri.

Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm

68%

e projekteve në përputhje me këto objektiva



arritjet kryesore



OBJEKTIVI 3
Shëndeti dhe Mirëqenia
5 projekte



OBJEKTIVI 4
Edukimi Cilësor
14 projekte



OBJEKTIVI 11
Qytete dhe Komunitete të Qendrueshme
20 projekte

Burimet Njerëzore

Me një staf prej 1265 punonjësish, Raiffeisen Bank është një nga punëdhënësit më të fuqishëm dhe më të mirë në Shqipëri, duke krijuar një mjedis konkurrues për sa i përket kompensimit, zhvillimit dhe motivimit të stafit.

Rekrutimi dhe Përzgjedhja e Stafit

Gjatë vitit 2021, procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së stafit synoi përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale në të gjitha nivelet e shërbimit në bankë, duke mbajtur komunikim të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm me menaxherët të linjës. Kjo për të kuptuar më mirë nevojat dhe kërkesat, për t'u njohur me objektivat ku do të fokusohet tërheqja e talentëve, duke identifikuar aftësitë dhe kompetencat e duhura.

Në mënyrë që të plotësojmë nevojat e biznesit në të gjitha fushat e veprimit, kemi punësuar një total prej 124 punonjësish të rinj.

Për të vlerësuar dhe përzgjedhur kandidatët më të mirë dhe profesionistët më të mirë në treg, gjatë situatës së pandemisë kemi aplikuar modalitetin e intervistave online dhe formateve të dhënies së feedback-ut online. Kemi aplikuar një proces rekrutimi të strukturuar prej disa fazash: testet teknike, logjike dhe/ose psikometrike si dhe testet e personalitetit. Kandidatët e përzgjedhur në këto faza bëhen pjesë e proceseve intervistuese, ku paneli është i përbërë nga supervisorët e departamentit/menaxherët të distrikteve dhe përfaqësues nga Divizioni i Burimeve Njerëzore.

Për Raiffeisen Bank, fokusi kryesor mbetet promovimi dhe zhvillimi i punonjësve të saj. Kandidatët e brendshëm, në bazë të performancës së tyre, u konsideruan si potenciali kryesor për pozicionet e lira të shpallura në bankë. Për vitin 2021, 35% e kandidatëve fitues për pozicionet e shpallura vakante kanë qenë punonjës të brendshëm. Kjo gjë krijon mundësi zhvillimi dhe ndërtimi të një karriere të suksesshme brenda institucionit dhe rritjen e motivimit të brendshëm të punonjësit.

Për të përbushur nevojat për staf në pozicione të nivelit bazë, në rrjetin e degëve dhe në zyrat qendrore, janë konsideruar me prioritet punonjës të punësuar nga shoqëri të jashtme, 30% e të cilëve u përzgjedhën për të plotësuar vendet vakante. Gjithashtu, studentët në Programin e Praktikës dhe studentët e programit DSA ishin burimi kryesor për plotësimin e këtyre pozicioneve.

Programi i praktikës

Raiffeisen Bank ka krijuar traditën e saj të programit të praktikës së studentëve. Synimi i këtij programi është të tërheqë studentë të cilët shfaqin një nivel të lartë motivimi, vullneti dhe dëshire për të punuar në një mjedis financiar. Banka është e angazhuar ndaj Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe programi i praktikës është një element i rëndësishëm i saj. Në mirëpresim studentë nga universitetet në të gjithë vendin, në mënyrë që ata të mësojnë në praktikë mënyrën se si funksionon banka dhe t'i ndihmojmë ata të përgatiten për tregun e punës.

Programi i Studentëve për Shitjet Direkte - DSA

Programi i Studentëve DSA gjatë vitit 2021 ka konsoliduar bashkëpunimin midis bankës dhe shumë universiteteve në vend, duke ftuar të marrin pjesë 196 studentë. Fokusi i këtij programi, i nisur nga Departamenti i Shitjeve dhe Marrëdhënieve Direkte, është rritja e shitjeve të produkteve të ndryshme në degë. Studentëve të përzgjedhur, të cilët punojnë si Agjentë të Shitjeve Direkte, u ofrohet trajnim dhe mbështetje nga shitës me eksperiencë gjatë gjithë programit njëvjeçar. Në fund të programit, ata fitojnë njohuri për produktet dhe proceset bankare dhe janë kandidatë potencialë për pozicionet e lira në bankë.

Ky program ka nxitur dhe shtuar biznesin në degë si dhe ka qenë një prurje shumë e mirë për plotësimin e vendeve të lira.

Programi "Key Academy"

Qëllimi i Programit "Key Academy" është të tërheqë talente potenciale të cilët më pas plotësojnë vendet vakante në Divizionin e IT, për të krijuar kandidatë potencialë për vendet vakante në Divizionin e IT-së. Në këtë program u përzgjedhën dhe u regjistruan 18 studentë – 100 përqind e të cilëve u rekrutuan në vendet vakante në Divizionin e IT-së.

Punonjës me kontratë të përkohshme nga shoqëri të jashtme

Gjate vitit 2021, Raiffeisen Bank ka vijuar bashkëpunimin me një shoqëri të jashtme, duke punësuar 63 punonjës, sipas kërkesave të rrjetit të degëve dhe departamenteve në zyrat qendrore.

Këta punonjës marrin trajnime teorike dhe në punë (on job), për të përmbushur në mënyrë efektive kërkesat e pozicioneve përkatëse. Punonjësit më të mirë inkurajohen për t'u bërë pjesë e procesit të rekrutimit për nevojat e bankës për staf të brendshëm.

Trajnimi

Në bankën tonë, aktivitetet e të mësuarit dhe zhvillimit në 2021 vijuan në një kombinim hibrid të modaliteteve online dhe atij në klasë. Vazhdimi i situatës së pandemisë edhe gjatë 2021, nuk na pengoi të promovonim dhe të vinim theksin në konceptin e të vetëmësuarit dhe mendësisë së të mësuarit në mënyrë të vazhdueshme.

Nëpërmjet komunikimit dhe kurseve të përzgjedhura, ne synuam që të ofronim një kontribut pozitiv në sigurinë psikologjike dhe mirëqenien e stafit tonë.

Banka ka mundësuar një varietet programesh trajnimi online dhe iniciativa të zhvillimit personal dhe profesional. Gjatë 2021, janë organizuar 7603 ditë trajnimi dhe 100% e stafit ka marrë pjesë në të paktën 1 sesion trajnimi. Edukimi i lidershit dhe menaxhimit është një tjetër fokus i Bankës Raiffeisen. Ne investuam në shumë programe trajnimi në modelet e reja të lidershit si: lidershi gjithëpërfshirës, lidershi në kohë krizash, menaxhimi i skuadrave në distancë, etj. Programet e trajnimit për mendësinë Agile, të mundësuar gjatë 2021, synuan që të mbështesnin stafin tonë që të përqafojnë lehtësisht mendësinë e zhdërvjellët dhe mënyrat e reja të të punuarit.

Divizioni i Burimeve Njerëzore mbështet qëllimet afatgjata të biznesit, duke zbatuar Strategjitë e Menaxhimit të Talenteve dhe të Planifikimit të Pasuesve. Banka është e fokusuar në identifikimin e punonjësve që dëshmojnë potencial të lartë arritjesh dhe performancë të qëndrueshme dhe zbaton plane që i përshtaten zhvillimit të tyre, me qëllim që të sigurojë angazhim afatgjatë të stafit.

Politika e shpërblimit të Grupit Bankar

Politikat e shpërblimit të Grupit Bankar hartohen nga Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe miratohen nga Drejtoria dhe Këshilli Drejtues. Përfshirja nga ky rregull bëhet vetëm në rastin e përcaktimit dhe miratimit të elementit variabël (bonus) për punonjësit e Raiffeisen Leasing, ku struktura përgjegjëse për përcaktimin dhe aprovimin e tij është Këshilli Drejtues i Raiffeisen Leasing.

Fokusi i politikës së shpërblimit është plotësimi i standardeve ndërkombëtare me qëllim krijimin e një strukture kompensimi të drejtë dhe transparente sipas kërkesave aktuale të enteve rregullatore. Politika e shpërblimit e Grupit Bankar është në përputhje të plotë me politikën dhe nxit frymën e menaxhimit të një risku efektiv, duke mos inkurajuar tejkalimin e niveleve të përcaktuara. Kjo politikë është në të njëjtën linjë me strategjinë e biznesit, objektivat, vlerave dhe interesave afat-gjatë të grupit RBI dhe të Grupit Bankar në Shqipëri.

Raiffeisen Bank Sh.a (përfshihet Raiffeisen Leasing) çdo vit identifikon funksionet/punonjësit me ndikim material në profilin e riskut të bankës. Këta punonjës përcaktohen si "Staf i Identifikuar" (Identified Staff) dhe procesi i tyre përzgjedhës bazohet në kërkesat/direktivat e grupit. Kategoritë e "Staf i Identifikuar" (Identified Staff) janë si më poshtë:

1. Material ose "Staf i Identifikuar" (Identified Staff) me ndikim të plotë. Kjo kategori ka një ndikim material direkt në profilin e riskut të bankës, sepse niveli i riskut i cili mund të jetë individual ose në grup, mund të ketë një ndikim thelbësor në rezultatet dhe pasqyrat financiare të bankës. Numri i punonjësve, të cilët plotësojnë këto kritere, është 47 dhe përfshin Anëtarët e Bordit Drejtues, Anëtarët e Drejtorisë, Anëtarët e Komitetit të Auditit si dhe disa Drejtues të nivelit të mesëm.

2. Pjesërisht Material ose "Staf i Identifikuar" (Identified Staff) me ndikim jo të plotë. Kjo kategori ka një ndikim në profilin e riskut të bankës, por jo domosdoshmërisht në një mënyrë të drejtpërdrejtë. Numri i punonjësve, të cilët plotësojnë këto kritere, është 27 dhe përfshin disa Drejtues të nivelit të mesëm.

Paga dhe përfitimet e tjera mbi pagën, përcaktohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë nivele të kënaqshme dhe konkurruese. Politika e ndjekur në përcaktimin e sistemit dhe strukturës së pagave duhet të realizojë dhe garantojë

Paga dhe përfitimet e tjera mbi pagën, përcaktohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë nivele të kënaqshme dhe konkurruese. Politika e ndjekur në përcaktimin e sistemit dhe strukturës së pagave duhet të realizojë dhe garantojë arritjen e 5 objektivave kryesore:

- Shpërblimi për performancën dhe cilësinë e punës.
- Ruajtjen e një pozicioni konkurrues në treg. Kompensimi i përgjithshëm duhet të jetë në kuadratin (quartile) e tretë të tregut lokal (midis 50 dhe 75 përqind).
- Motivimin e punonjësve nëpërmjet shpërblimit (pagës) të diferencuar për përgjegjësi, pozicione pune dhe aftësi profesionale.
- Përfitimet shtesë duhet të jenë konkurruese, por jo kryesuese në treg.

Shpenzimet për pagat në totalin e kostos së personelit dhe buxhetit në tërësi, të jenë në parametra të pranueshëm.

Për një kategori të caktuar pozicionesh, paga është e përbërë nga dy elemente:

- Paga bazë
- Paga variabël

Struktura e pagës bazë

- Përfaqëson të ardhurat bruto, duke përjashtuar bonuset dhe përfitimet e tjera shtesë;
- Administrohen në bazë të niveleve të pagës, të cilat bazohen në strukturën e gradës, nivelin e jetesës në vend dhe të dhënat e tregut;
- Rritja e pagave është e lidhur ngushtë me rezultatin e performancës individuale. Kjo do të thotë që çdo punonjësi i lind e drejta për të përfituar rritje page kur niveli i performancës individuale është mbi 3.5 (vlera maksimale është 5). Përqindja e rritjes së pagës nuk do të jetë më e lartë se 25 përqind e pagës bruto.

Paga Variabël (Bonusi i Përgjithshëm / Bonusi Vjetor)

Paguhet apo përfitohet vetëm nëse plotësohen të gjitha kriteret rregullatore pranuese, të parashikuara në Politikën e Shpërblimit.

- Është e lidhur ngushtë me rezultatet e performancës së Grupit RBI (1/3); Bankës (2/3); Individit (mbi 3.5);
- Ka një kufi, në mënyrë që të sigurohet një menaxhim i buxhetit brenda parametrave të arsyeshëm, pa shkelur parimin e shpërblimit të performancës së lartë;
- Nuk do të jetë më e lartë se: 16 përqind e pagës bazë vjetore për të gjitha pozicionet që janë të përfshira në bonusin vjetor;
- Nëse shuma totale e Kompensimit Variabël në terma vjetore tejkalon nivelin e 50'000 Euro si dhe një të tretën e shpërblimit total vjetor, për kategorinë "Identified Staff" do të aplikohet një skemë e ndryshme pagese.

Në rastet e një performance financiare negative, bonusin vjetor mund të reduktohet apo anulohet.

Paga Variabël (Skemat Nxitëse me Risk të ulët)

- Është e lidhur ngushtë me rezultatet e performancës së Individit (mbi 70 përqind realizim objektiv);
- Ka një kufi, në mënyrë që të sigurohet një menaxhim i buxhetit brenda parametrave të arsyeshëm, pa shkelur parimin e shpërblimit të performancës së lartë.
- Nuk do të jetë më e lartë se: 30 përqind e pagës bazë 3-mujore për të gjitha pozicionet që janë të përfshira në skemat nxitëse (shitëse dhe mbështetëse)

Tabelë 19:** Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues (çdo fund viti)
(shumat në lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/ për periudhën aktuale Viti 2021	Për periudha të kaluara Viti 2020
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	12,497	12,544.98
Cash/bonus	12,497	12,544.98
Aksione		
Të tjera		
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit		
Cash/bonus		
Aksione		
Të tjera		


** Kjo tabelë do të plotësohet më vete për a) Këshillin Drejtues dhe b) drejtuesit ekzekutivë.

Tabelë 19:** Format dhe elementët e shpërblimit për Drejtuesit ekzekutivë (çdo fund viti)
(shumat në lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/ për periudhën aktuale Viti 2021	Për periudha të kaluara Viti 2020
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	200,977	209,413
Cash/bonus	177,949	183,888
Aksione		
Të tjera	22,998	25,525
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit	28,932	7,933
Cash/bonus	28,932	7,933
Aksione		
Të tjera	0	0


** Kjo tabelë do të plotësohet më vete për a) Këshillin Drejtues dhe b) Drejtuesit Ekzekutivë.

Struktura Organizative e Raiffeisen Bank



Struktura organizative e bankës siguron një ndarje të qartë të detyrave, përgjegjësi dhe raportimit, sipas modelit të tre linjave të kontrollit:

- i. Linja e pare e frontit (Biznesi)
- ii. Rreziku Operacional, Funksonet e Pëputshmërisë, Kontrolltet financiare, Sistemi i Kontrollit të Brendshëm, etj.
- iii. Auditi i Brendshëm



Struktura e Rrezikut është e pavarur nga linjat e biznesit dhe njësite e tjera të brendshme që kontrollojnë. Struktura e Përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe njësite e tjera të brendshme që kontrollojnë.

Raiffeisen Bank sh.a. vepron në përputhje me parimet bazë të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv sipas kërkesave të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratoreve të tyre".

Përmbajtje

Raiffeisen Bank Sh.a.
Pasqyrat financiare të konsoliduara
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(me raportin e audituesve të pavarur)

Raporti i audituesve të pavarur	42
Grupi	44
Pasqyra e konsoliduar e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse	45
Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	46
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital	47
Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë	48
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara	49
Deklarata e përfaqësuesve ligjorë	129

**Deloitte Audit Albania sh.p.k**

Rruga e Kavajes, ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji,
Godina L
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Aksionarëve dhe Drejtimit të Raiffeisen Bank Albania SHA,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit Raiffeisen ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2021 si dhe performancën e tij financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Grupi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi "BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Grupit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi ato pasqyra financiare më 11 qershor 2021.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në Raportin Vjetor, i për gatitur nga Drejtimi i Grupit në përputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe me Nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit mbi këto pasqyra. Raporti Vjetor pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim konkluzione që japin siguri lidhur me këto informacione. Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që kemi marrë gjatë auditimit ose në rast se përmbajnë anomali materiale. Kur të lexojmë Raportin Vjetor, nëse ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë anomali materiale, atëherë, ne na kërkohet të raportojmë mbi këtë fakt palëve të ngarkuara me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Grupit për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Grupit, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Konsoliduara

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Grupit për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënime shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Marrja e mjaftueshme e evidencave të përshtatshme auditimi në lidhje me informacionin financiar të entiteteve ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit të grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Grupit, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania SHPK

Rruga e Kavajes, ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Tiranë, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara

Partner Angazhimi

Auditues ligjor

16 June 2022

Tiranë, Shqipëri

Grupi

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 për Raiffeisen Bank sh.a. dhe filialet e saj ("Grupi"). Grupi përfshin shoqërinë mëmë - Raiffeisen Bank Sh.a. (në vijim "Banka" ose "Shoqëria Mëmë") dhe dy filialet e saj plotësisht të zotëruara Raiffeisen Leasing sh.a. dhe Raiffesien Invest - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensioneve dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. ("Raiffeisen INVEST").

Raiffeisen Bank sh.a është një institucion bankar i themeluar në përputhje me Ligjin 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" datë 14 prill 2008 dhe me Ligjin 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" datë 18 dhjetor 2006 si edhe ligje të tjera të aplikueshme. Banka është krijuar dhe themeluar në Shqipëri dhe vepron vetëm në Shqipëri. Raiffeisen Bank Sh.a. është një degë në pronësi 100% të Raiffeisen Bank International AG, Austri, e cila është shoqëria mëmë përfundimtare .

Aktivitetet kryesore të biznesit të Grupit janë operacionet bankare me pakicë, ofrimi i qirave financiare për shoqëritë dhe individët dhe grumbullimin dhe investimin e fondeve të pensioneve vullnetare brenda Republikës së Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2021, Banka operon nëpërmjet një rrjeti bankar prej 74 pikash shërbimi, (2020: 76 pika shërbimi) në të gjithë Shqipërinë, të cilat drejtohen nga 3 rrethe (2020: 6 rrethe) dhe nuk ka aktivitete jashtë shtetit.

Pasqyra e konsoliduar e fitim humbjes dhe e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

në mijë LEK	Shënim	2021	2020
Të ardhurat nga interesat llogaritur me metodën e interesit efektiv		7,060,570	6,836,762
Të ardhurat të tjera nga interesat		556	684
Shpenzime për interesa		(264,793)	(254,377)
Të ardhurat nga interesat, neto	[1]	6,796,333	6,583,069
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		3,840,073	3,187,580
Shpenzimet për tarifa dhe komisione		(1,374,019)	(1,204,671)
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet, neto	[2]	2,466,054	1,982,909
Humbje tregtare neto	[3]	225,705	579,309
Të ardhura të tjera operative		40,970	47,582
Shpenzime të tjera operative		(286,255)	(179,072)
Humbje të tjera operative, neto	[4]	(245,285)	(131,490)
Të ardhurat operative, neto		9,242,807	9,013,797
Shpenzime të përgjithshme administrative	[5]	(5,170,001)	(5,092,796)
Masat e veçanta qeveritare	[6]	(693,141)	(655,953)
Rimarrje e zhvlerësimeve financiare, neto	[7]	757,124	(1,188,692)
Fitimi para tatimit		4,136,789	2,076,356
Tatimi mbi fitimin	[8]	(724,534)	(403,335)
Fitimi për vitin		3,412,255	1,673,021
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		3,412,255	1,673,021

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar së bashku me shënimet, në faqet 42 deri në 129, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021

Aktive

në mijë LEK	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Arka, banka qendrore dhe depozita të tjera pa afat	[9]	42,813,051	56,327,181
<i>Letra me vlerë të borxhit</i>		80,394,977	59,171,534
<i>Hua dhe paradhënie për institucionet financiare</i>		36,728,182	27,233,140
<i>Hua dhe paradhënie për klientët</i>		107,036,227	88,305,614
Aktive financiare – me kosto të amortizuar	[10]	224,159,386	174,710,288
Aktive financiare – me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	[11]	12,222	5,015
Emri i mirë	[12]	92,783	92,783
Aktive tatimore aktuale		-	193,328
Aktive afatgjata materiale, neto	[13]	3,163,777	2,880,126
Aktive afatgjata jomateriale, neto	[13]	1,623,371	1,470,260
Aktive të riposeduara	[14]	712,457	1,054,297
Aktive të tjera	[15]	822,832	821,096
Aktive totale		273,399,879	237,554,374

Detyrime dhe kapitali aksionar

Detyrime	Shënim	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Depozitat nga bankat			
<i>Depozitat nga klientet</i>		13,808,180	4,470,562
<i>Detyrime të tjera financiare</i>		225,130,048	200,249,819
<i>Detyrimet financiare – me kosto të amortizuar</i>		3,096,467	1,526,216
Provizione për detyrimet	[16]	242,034,695	206,246,597
Detyrimet tatimore të shtyra	[17]	383,447	290,551
Detyrime tatimore aktuale	[18]	26,314	23,665
Detyrime të tjera	[19]	147,831	-
Totali i detyrimeve	[20]	657,112	567,189
Kapitali aksionar		243,249,399	207,128,002
Kapitali aksionar			
Rezerva të tjera		14,178,593	14,178,593
Fitimi i pashpërndarë	[21]	3,306,190	3,306,190
Totali i kapitalit aksionar	[21]	12,665,697	12,941,589
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		30,150,480	30,426,372
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		273,399,879	237,554,374

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Bordi Drejtues i Grupit më 8 Qershor 2022 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Christian Canacaris
Drejtor Ekzekutiv



Alexander Zsolnai
Nën kryetar i Bordit të Drejtimit

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet, në faqet 42 deri në 129, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital më 31 dhjetor 2021

në mijë LEK	Kapitali aksionar	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Kapitali më 1 janar 2020	14,178,593	3,306,190	11,268,568	28,753,351
Fitimi për vitin	-	-	1,673,021	1,673,021
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	1,673,021	1,673,021
Kapitali më 31 dhjetor 2020	14,178,593	3,306,190	12,941,589	30,426,372
Kapitali më 1 janar 2021				
Pagesat e dividendëve	-	-	(3,688,147)	(3,688,147)
Fitimi për vitin	-	-	3,412,255	3,412,255
Ndryshime të tjera	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	3,412,255	3,412,255
Kapitali më 31 dhjetor 2021	14,178,593	3,306,190	12,665,697	30,150,480

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet, në faqet 42 deri në 129, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

në mijë LEK	Shënim	2021	2020
Paratë dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar	[9]	64,799,985	42,269,288
Aktivitetet operative:			
Fitimi para tatimit		4,136,789	2,076,356
Rregullimet për rakordimin e fitimit/humbjes pas tatimit me flukset e parasë nga aktivitetet operative:			
Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	[5]	709,958	770,307
Zhvlërësimi dhe anulimi i zhvlërësimit të aktiveve	[7]	(831,111)	1,145,689
Provizionet neto për detyrimet dhe humbjet nga zhvlërësimi		73,986	43,002
Të ardhurat nga interesi, neto	[1]	(6,795,264)	(6,583,069)
Interesi i arkëtuar		6,264,157	3,438,221
Interesi i paguar		(1,173,230)	(205,753)
Tatimi mbi të ardhurat		(351,835)	-
Efekt nga ndryshimi i kursit të këmbimit		(246,708)	(40,057)
Fitimi nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara		(24,414)	(16,121)
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet operative pas rregullimeve për pozicionet jo-monetare:		-	-
Paksimi i balanceve të kufizuara	[9]	(2,071,895)	(1,267,605)
Aktivitet financiarë – me kosto të amortizuar	[10]	(18,212,389)	8,981,496
Aktive financiare – me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	[11]	(7,207)	(2,162)
Aktive tatimore aktuale		-	(94,120)
Aktive të tjera	[15]	339,982	340,050
Detyrimet financiare – me kosto të amortizuar	[16]	37,318,481	13,912,306
Provizionet për detyrimet dhe detyrimet	[17]	18,525	(41,822)
Detyrime të tjera	[20]	59,737	(51,666)
Fluksi i parasë neto nga aktivitetet operative		19,207,562	22,405,052
Aktivitetet investuese:			
Blerja e investimeve në letra me vlerë dhe aksione		(42,159,321)	(32,556,636)
Blerja e aktiveve aktiveve të qëndrueshme materiale dhe jomateriale		(1,118,175)	(1,143,766)
Të ardhurat nga investime në letra me vlerë dhe aksione të maturuara		21,675,762	35,909,900
Të ardhurat nga aktivet fikse materiale dhe jo-materiale		12,761	17,916
Fluksi i parasë neto nga aktivitetet investuese		(21,588,973)	2,227,414
Aktivitetet e financimit:			
Flukse dalese të borxhit të varur	[16]	-	(1,865,100)
Flukse dalëse të qerave		(266,796)	(276,726)
Pagesat e dividendëve		(3,688,147)	-
Fluksi i parasë neto nga aktivitetet e financimit		(3,954,943)	(2,141,826)
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar	[9]	64,799,985	42,269,288
Efekt i ndryshimeve të kursit të këmbimit		246,708	40,057
(Rënia)/rritja neto gjatë vitit		(6,336,354)	22,490,640
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	[9]	58,710,339	64,799,985

Pasqyra e konsoliduar e flukseve të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet, në faqet 42 deri në 129, të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare të konsoliduara

Parimet bazë të pasqyrave financiare të konsoliduara

Parimet e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Grupi ka konsideruar ndikimin e Covid 19 në përgatitjen e pasqyrave të saj financiare. Ndërsa fushat specifike të gjykimit mund të mos ndryshojnë, ndikimi i Covid - 19 rezultoi në zbatimin e gjykimit të mëtejshëm brenda atyre zonave për shkak të natyrës evolucionare të pandemisë dhe përvojës së kufizuar të ndikimeve ekonomike dhe financiare të një ngjarjeje të tillë. Gjithashtu, ndryshime të rëndësishme në vlerësimet janë bërë në matjen e aktiveve dhe pasiveve të njësive ekonomike.

Në pasqyrat financiare të konsoliduara, filialet - të cilat janë ato shoqëri në të cilat Grupi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votës ose ka fuqi të ushtrisë kontroll mbi veprimtaritë operacionale - janë konsoliduar plotësisht. Pasqyrat financiare të konsoliduara mund të aksesohen në website nga <http://www.raiffeisen.al/>. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare individuale duhet t'i lexojnë ato së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 me qëllim të marrjes së informacionit të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatet e operacionale dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit si një i tërë.

Burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimit kritike kontabël

Nëse vlerësimet janë të nevojshme për kontabilizimin dhe matjen sipas SNRF-ve, ato bëhen në përputhje me standardet përkatëse. Ato bazohen në përvojën e kaluar dhe në faktorë të tjerë, siç janë planifikimi dhe pritjet ose parashikimet e ngjarjeve të ardhshme që duket të jenë të mundshme. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në vlerësimet që prekin vetëm një periudhë do të merren në konsideratë vetëm në atë periudhë. Nëse periudhat e raportimit në vijim gjithashtu preken, ndryshimet do të merren në konsideratë në periudhën aktuale dhe në vijim. Supozimet kritike, vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit janë si më poshtë:

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Zbatimi i politikave kontabël të Grupit kërkon gjykime kontabël të drejtimit. Grupi vlerëson në bazë të parashikimit humbjet e pritura kreditore të lidhura me aktivet e saj si instrumenta borxhi të mbartura me koston e amortizuar dhe me ekspozimin që rrjedhin nga angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Llogaritja e humbjeve të pritshme kreditore (HPK) kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël që sipas përkufizimit nuk përputhen gjithmonë me rezultatet aktuale. Shuma e zhvlerësimit që do të alokohet varet nga ndryshimi në rrezikun e deshtimit të një instrumenti financiar pasi të jetë njohur. Për të përcaktuar shumën e zhvlerësimit, parametrat e rëndësishëm të rrezikut të kredisë si PM (Probabiliteti i Mospagesës), HM (Humbja në rast Mospagese) dhe EM (Ekspozimi në rast Mospagese), si dhe informacione të orientuara drejt së ardhmes (parashikimet ekonomike) vlerësohen nga drejtimi. Zbritja për rreziqet e kredisë rregullohet për këtë humbje të pritshme në çdo datë raportimi. Metodot për përcaktimin e shumës së zhvlerësimit shpjegohen në seksionin Zhvlerësimi i përgjithshëm (SNRF 9) nën Parimet e Njohjes dhe Matjes. Për detaje shtesë mbi zhvlerësimin e aktiveve financiare, referojuni shënimit 26 Humbja e Pritshme e Kredisë dhe shënimit 35 Rreziqet e Kredisë.

Parimi i Vijmësisë

Gjatë fillimit të vitit 2020, në nivel global u përhap pandemia e COVID-19. Që prej 31 dhjetorit 2019, pasojat e përhapjes së COVID-19 kanë ndikuar negativisht ofertën dhe kërkesën e produkteve kryesore të Bankës, dhe për rrjedhojë, rezultatet operative të saj janë ndikuar negativisht. Në mars të vitit 2020, qeveria e Shqipërisë mori masa drastike duke pezulluar të gjitha aktivitetet që nuk ishin jetësore. Megjithëse, veprimtaritë e Bankave nuk u pezulluan, pandemia krijoi vonesa në pagesa në disa nga klientët e Bankës. Banka e Shqipërisë ka njoftuar një "moratorium pagese", prandaj klientët që do të përballen me probleme të likuiditetit mund të kërkojnë një shtyrje të shlyerjes së detyrimeve të tyre ndaj bankave deri më 31.08.2020. Qeveria shqiptare njoftoi dy garanci sovranë për të mbështetur të gjithë bizneset që po përballeshin me probleme likuiditeti dhe do të kërkonin financim. Programi i parë synonte të financonte menjëherë "pagesat e pagave" për punonjësit e biznesit ndërsa i dyti parashikon një mbështetje afatgjatë të biznesit që përballen me çështje që lidhen me bllokimin nga pandemia COVID-19.

Aktiviteti i Grupit ka vazhduar pa pezullim gjatë vitit 2021, dhe ka pasur një ecuri relativisht të qëndrueshme në arkëtueshmërinë e klientëve. Për vitin 2021, Grupi pret një rritje të portofolit të kredive joperformuese për shkak të rënies ekonomike. Pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, Grupi ka analizuar ndryshimet makro-ekonomike dhe pasqyruar këto ndryshime në testet e stresit të përdorura për të përshkruar ndikimin e COVID-19 në llogaritjen e Humbjes së Pritshme të Kredisë.

Grupi konsideron në vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të tij të brendshëm skenarin e stresit në llogaritjen e kërkesës së kapitalit për rrezikun e tregut në lidhje me portofolin e tij të investimeve, shumica e të cilave maten me kosto të amortizuar. Luhatja në vlerat e drejta pritet të ketë një ndikim minimal në rezultatet e Grupit për shkak të

BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT DHE GJYKIMET KRITIKE KONTABËL - VAZHDIM PARIMI I VIJIMËSISË - VAZHDIM

madhësisë së vogël të portofolit të Grupit të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Grupi e konsideron rrezikun e likuiditetit në planet e rimëkëmbjes, në procesin e vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit të brendshëm, duke vendosur kufij të përcaktuar mirë për oreksin e tij për rrezik. Grupi përcakton që burimet e tij kapitale janë të disponueshme.

Grupi kryen rregullisht, ushtrime të testit të stresit, për të provuar ndikimin e mundshëm të treguesve makroekonomikë në pozicionin kryesor financiar të grupit, performancën dhe pajtueshmërinë rregullatore. Këto teste stresi janë përqendruar kryesisht në ndikimin që disa skenarë makro dhe mikroekonomikë të përshkruara mund të kenë në portofolin e kredisë, duke qenë burimi kryesor i të ardhurave, pozicioni financiar i Grupit, përfshirë edhe rrezikun e tregut. Në këto analiza janë përdorur modelet zyrtare të parashikimit të vlerësimit të rrezikut të brendshëm të Bankës Qendrore dhe të Grupit.

Testet dinamike kryhen për të vlerësuar efektin që një rritje / ulje e ngjashme gjate goditjes së klientit do të kishte në secilin prej pasqyrave të aktiveve, detyrimeve dhe zërave të fitimit dhe humbjes, për një periudhë specifike kohore.

Konflikti i vazhdueshëm ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet e lidhura me të, të synuara kundër Federatës Ruse, mund të kenë ndikim në ekonominë evropiane dhe globalisht. Banka nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ndaj Ukrainës, Rusisë apo Bjellorusisë. Megjithatë, ndikimi në situatën e përgjithshme ekonomike mund të kërkojë rishikime të supozimeve dhe vlerësimeve të vecanta. Kjo mund të çojë në sistemime materiale të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të caktuara në të ardhmen. Në këtë fazë, drejtimi nuk është në gjendje të vlerësojë me besueshmëri ndikimin pasi ngjarjet po shpalosen çdo ditë. Ndikimi afatgjatë do të duhet të vlerësohet vazhdimisht për sa i përket vëllimeve të tregtimit, flukseve monetare dhe përfitimit.

Drejtimi i Grupit ka bërë një vlerësim mbi aftësinë e Grupit për të vazhduar aktivitetin ekonomik sipas parimit të vijimësisë duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e përmendur më lart dhe është konfident që Grupi ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin në të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, Drejtimi nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin e saj ekonomik. Prandaj, Pasqyrat Financiare individuale vazhdojnë të jenë të përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Për shënime shpjeguese shtesë mbi drejtimin e kapitalit referojuni shënimit 46.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë është çmimi i marrë për shitjen e një aktivi ose i paguar për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Kjo vlen pavarësisht nëse çmimi mund të vëzhgohet drejtpërsëdrejti ose është vlerësuar në bazë të një metode matjeje. Në përcaktimin e vlerës së drejtë të një aktivi ose detyrimi, Grupi merr në konsideratë disa karakteristika të aktivitetit ose detyrimit (p.sh. gjendjen dhe vendndodhjen e aktivitetit ose kufizimet në shitjen dhe përdorimin e një aktivi) nëse pjesëmarrësit e tregut do të konsideronin gjithashtu karakteristikat në përcaktimin e çmimit për blerjen e aktivitetit përkatës ose për transferimin e pasivitetit në datën e matjes. Kur tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur një teknikë vlerësimi ose model të çmimeve. Për metodat dhe modelet e vlerësimit, përgjithësisht përdoren vlerësime të varura nga kompleksiteti i instrumentit dhe disponueshmëria e të dhënave të bazuara në treg. Inputet e këtyre modeleve rrjedhin nga të dhënat e tregut të vëzhgueshme aty ku është e mundur. Në rrethana të caktuara, rregullimet e vlerësimit janë të nevojshme për të llogaritur faktorë të tjerë, si rreziku i modelit, rreziku i likuiditetit ose rreziku kreditor. Modelet e vlerësimit janë përshkruar në shënimet në seksionin mbi instrumentet financiare - gjatë njohjes dhe parimeve të matjes.

Veç kësaj, vlerat e drejta të instrumenteve financiare shpalosen në shënimin (22) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare.

Vlera neto e realizueshme e kolateraleve të riposeduara

Kolaterale të riposeduara paraqesin aktivitetet e pasurive të patundshme të marra nga Grupi në shlyerjen e kredive të vonuara të cilat klasifikohen si inventarë në përputhje me SNK 2 "Inventarët". Aktivitetet fillimisht njihen me vlerën e drejtë kur merren dhe maten me vlerën më të ulët të kostos dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje. Grupi rivlerëson këto aktive në baza vjetore duke përdorur një ekip të përbërë nga vlerësues të jashtëm të pavarur dhe vlerësues të certifikuar të brendshëm, të cilët kanë kualifikime të duhura profesionale dhe përvojë të fundit në vendin dhe kategorinë e pronës që vlerësohet. Kjo shpaloset në notën (14).

Aktive për tatime të shtyra

Aktivitetet tatimore të shtyra njihen vetëm në masën që është e mundshme që në të ardhmën të jetë e disponueshme fitimi i mjaftueshëm i tatuueshëm, ndaj të cilit mund të përdoren humbjet tatimore, kreditë tatimore ose diferencat e përkohshme të zbritshme. Për këtë qëllim përdoret një periudhë planifikimi prej pesë vjetësh. Ky vlerësim kërkon gjykime të rëndësishme dhe supozime që duhet të bëhen nga drejtimi. Në përcaktimin e shumës së aktiveve tatimore të shtyra, drejtimi përdor informacionin e kapacitetit tatimor historik dhe informacionin e përfitueshmërisë dhe, nëse është relevante, rezultatet operative të parashikuara në bazë të planeve të miratuara të biznesit, duke përfshirë një rishikim të periudhës së transferimit të pranueshëm.

BURIMET KRYESORE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT DHE GJYKIMET KRITIKE KONTABËL - VAZHDIM PARIMI I VIJIMËSISË - VAZHDIM

Tatimet e shtyra nuk janë raportuar veçmas në pasqyrën e të ardhurave dhe janë shpalosur nën (8) Tatimet mbi të ardhurat. Në të kundërt, tatimet e shtyra janë paraqitur veças në pasqyrën e pozicionit financiar në shënimet nën (18) Aktivet tatimore.

Politikat e kontabilitetit në lidhje me COVID-19

Moratoriumet e pagesave

Shqipëria ishte pjesë e vendeve që aplikuan moratorium pasi rastet e Covid-19 u rritën në vend. Moratoriumi e parë në Shqipëri u miratua me vendim të përbashkët të Kryeministrit dhe Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për një periudhë 3 muaj mars - maj 2020. Një i dytë menjëherë ndoqi të parën për 3 muaj shtesë qershor - gusht 2020. Të dy moratori-umet ishin me zgjedhje, por gjithashtu jo të detyrueshme për bankat, që kishin vendimin përfundimtar për të pranuar ose jo kërkesën e klientit për të qenë pjesë e ndonjërit prej moratoriumeve. Sidoqoftë bankat ishin shumë të hapura për të pranuar kërkesën e klientëve. Për moratoriumin e parë, me vendim të Bordit Drejtues, Raiffeisen Bank Albania ven-dosi të pranojë të gjitha kërkesat në të gjitha segmentet e biznesit. Për moratoriumin e dytë, Grupi mori vendimin bazuar në argumente dhe dha informacione që justifikojnë kërkesën.

Moratoriumet e pagesave nuk konsiderohen se shkaktojnë automatikisht një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë (SICR). Në vend të kësaj, Grupi do të vazhdojë të zbatojë kriteret e saj të përcaktuara të vlerësimit që përbëhen nga informacione cilësore dhe pragje sasore.

Programet direkte të qeverisë

Qeveria shqiptare mbështeti bizneset dhe individët privatë të prekur nga pandemia me masa dhe mekanizma të ndryshëm. Dy prej tyre si një program garancie për bizneset. Programi i parë ishte një garanci dhe një skemë e plotë që mbulonte financimin e pagave deri në 3 muaj (mars - maj) me një kufi për një pagë maksimale prej rreth 1,200 EUR. Kohëzgjatja e këtij programi tashmë ka përfunduar.

Skema e dytë ofroj një garanci deri në 60% të shumës së principalit, kufiri maksimal i një shoqërie afërsisht 2,4 milion EUR. Kompanitë mund ta përdorin huanë për investime dhe financim të kapitalit qarkullues. Afati I këtij programi ka përfunduar në fund të qershor 2021.

Përmbledhje e huave të modifikuara në lidhje me programet e qeverisë direkte

Tabelat e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje të aktiveve të modifikuara të Bankës më 31 Dhjetor 2021.

Në mijë LEK	Niveli 2			Niveli 3				
	Modifikimi i përkohshëm dhe i përhershëm	Rifinancimi	Totali	HPK	Modifikimi i përkohshëm dhe i përhershëm	Rifinancimi	Totali	HPK
Korporatat Jo-financiare	2,570,074	2,062,685	4,632,759	468,460	4,629,225	-	4,629,225	3,436,300
Individuale	1,036,293	-	1,036,293	140,181	537,727	-	537,727	338,386
Total	3,606,367	2,062,685	5,669,052	608,641	5,166,952	-	5,166,952	3,774,686

Përkthimi në monedhë të huaj

Pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit janë përgatitur në LEK, e cila është monedha funksionale e Grupit. Monedha funksionale është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin operon Grupi.

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve. Aktivët dhe detyrimet monetare të shprehura në valuta të huaja në datën e raportimit janë rikthyer në kursin funksional me kursin e këmbimit në atë datë.

Fitimi ose humbja në valutë në zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interes efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston e amortizuar në monedhë të huaj të përkthyer me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedha të huaja që maten me vlerën e drejtë, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

Normat e aplikueshme zyrtare të Grupit (LEK në njësinë e monedhës së huaj) për monedhat kryesore në 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 ishin si më poshtë:

	2021		2019	
	Më 31 dhjetor	Mesatar 1 Janar- 31 dhjetor	Më 31 dhjetor	Mesatar 1 Janar- 31 dhjetor
Normat në LEK për njësitë				
Njësia monetare e Bashkimit Evropian (EUR)	120.76	124.07	123.70	124.07
Dollari amerikan (USD)	106.54	108.66	100.84	108.66

Ju lutemi vini re se politikat e tjera kontabël të grupit janë shpalosur në "Parimet e njohjes dhe matjes" në faqen 66.

Zbatimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

Me përjashtim të ndryshimeve më poshtë, Grupi ka zbatuar vazhdimisht politikat e kontabilitetit në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Standartet e reja te hyra në fuqi më 1 janar 2021

Disa deklarata të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive nga 1 Janari 2020 dhe për këtë arsye janë miratuar nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Grupit.

Standartet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standartet ekzistuese dhe interpretimi i lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) janë në fuqi për periudhën aktuale të raportimit:

- Ndryshime të SNRF 9 "Instrumentat Financiare", SNK 39 "Instrumentet Financiare - Njohja dhe Vlerësimi", SNRF 7 "Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese", SNRF 4 "Kontratat e sigurimeve" dhe SNRF 16 "Qirate – Reforma e Standardit të Normave së Interesit – Faza e 2 (ne fuqi për periudhat raportuese me fillim në 1 janar 2021)
- Ndikimi i aplikimit fillestar të Koncesioneve të Qirasë lidhur me COVID-19 përtej 30 Qershorit 2021—ndryshimi i SNRF 16
- Ndryshime të SNRF 16 "Qiratë" - aplikimit fillestar të Koncesioneve të Qirasë lidhur me COVID-19 (në fuqi nga 1 Prill 2021 për vitin financiar që fillon më 1 janar 2021)
- Ndryshime të SNRF 4 "Kontratat e Sigurimeve" – Zgjatja e përjashtimeve të përkohshme në aplikimin e SNRF 9 (data e përfundimit të përjashtimeve të përkohshme nga IFRS 9 është shtyrë më 1 janar 2023).
- Ndikimi i aplikimit fillestar të Koncesioneve të Qirasë lidhur me COVID-19 përtej 30 qershor 2021—ndryshime te SNRF16

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye nuk janë bërë shpalosje.

Standartet, ndryshimet dhe Interpretimet e Standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Grupi.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standartet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standartet ekzistuese dhe interpretimet e reja ishin në fuqi, por nuk janë ende efektive:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit - Efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023
- SNRF 16 Qiratë - Koncesionet e qirave të lidhura me Covid-19 për periudhën pas 30 Qershorit 2021 (efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 prill 2021. Zbatimi i mëparshëm lejohet, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për lëshim në datën e ndryshimeve në standart.)
- Ndryshimet në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Pjesëmarrësit dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta - Shitja ose Kontributi i Aseteve ndërmjet një Investitori dhe Shoqëruesit të tij ose Sipërmarrjeve të Përbashkëta - Data e hyrjes në fuqi nuk është caktuar ende
- Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare-Klasifikimi i Detyrimeve si Aktuale ose Jo-Aktuale- Data e hyrjes në fuqi fillon më ose pas datës 1 janar 2023
- Ndryshimet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit - Referenca në Kuadrin Konceptual - Efektive në ose pas 1 Janarit 2022 - me aplikim të hershëm të lejuar
- Ndryshimet në SNK 16 Aktivët afatgjatë materiale - Të ardhurat përpara përdorimit të synuar - Data e hyrjes në fuqi fillon më ose pas 1 janarit 2022, me aplikimin e hershëm të lejuar
- Ndryshimet në SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët Kontingjente—Kontrata të rënda—Kostoja e përmbushjes së një kontrate- Data e hyrjes në fuqi fillon më ose pas 1 janarit 2022, me aplikimin e hershëm të lejuar

- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF 2018-2020—Ndryshimet në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNRF 16 Qiratë dhe SNK 41 Bujqësia - Data e hyrjes në fuqi fillon më 1 janar ose pas datës 20. Lejohet aplikimi i hershëm
- Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2 Bërja e gjykimeve të materialitetit-Shpalosja e politikave kontabël- Ndryshimet në SNK 1 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2023 ose pas, me aplikim më të hershëm të lejuar dhe zbatohen në mënyrë prospektive.
- Ndryshimet në SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet—Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe, me aplikim të mëhershëm të lejuar.
- Ndryshimet në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat - Tatimi i Shtyrë në lidhje me Aktivitetet dhe Detyrimet që rrjedhin nga një Transaksion i Vetëm - në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me aplikim më të hershëm të lejuar.

Drejtimi parashikon që të gjitha njoftimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit.

SHËNIME PËR PASQYRËNË TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

1. TË ARDHURA NGA INTERESAT, NETO

në mijë LEK	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesat		
Aktive financiare - kosto e amortizuar	7,015,387	6,782,122
Aktive të tjera	43,818	52,825
Të ardhura nga interesat mbi detyrimet financiare	1,365	1,815
Të ardhurat nga interesat me metodën e interesit efektiv	7,060,570	6,836,762
Të ardhura të tjera nga interesat	556	684
Totali i të ardhurave nga interesi	7,061,126	6,837,446
Shpenzime për interesat		
Detyrimet financiare - kosto e amortizuar	(49,900)	(99,149)
Shpenzimet e interesit për aktivet financiare	(194,494)	(132,153)
Shpenzimet e interesit për detyrimet e qirasë	(20,399)	(23,075)
Shpenzimet totale të interesit	(264,793)	(254,377)
Të ardhura nga interesat, neto	6,796,333	6,583,069

Të ardhurat nga interesi duke përdorur normën efektive të interesit të njohur për fazën 3 në 2021 janë 142 milionë LEK (2020: 156 milionë LEK). Shpenzimet e interesit nga aktivet financiare janë interesi negativ i vendosjeve. Rritja e shpenzimeve të interesit për aktivet financiare ka të bëjë me rritjen e vendosjeve gjatë vitit 2021 (për më shumë detaje referojuni shënimit 11).

2. TË ARDHURA NGA TARIFAT DHE KOMISIONET, NETO

në mijë LEK	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klringu, shlyerja dhe shërbimet e pagesave	2,406,877	1,946,746
Kredi për biznesin	128,364	91,297
Letrat me vlerë	12,848	15,445
Transaksionet në valutë të huaj	209,587	165,608
Të tjera	1,065,743	953,220
Të ardhurat totale nga komisionet nga kontratat me klientët	3,823,419	3,172,316
Kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë	16,654	15,264
Të ardhurat totale nga komisionet	3,840,073	3,187,580
Klringu, shlyerja dhe shërbimet e pagesave	(940,441)	(894,052)
Kredi dhe garanci për biznesin	(143,092)	(52,262)
Të tjera	(290,486)	(258,357)
Totali i shpenzimeve të komisioneve nga kontratat me klientët	(1,374,019)	(1,204,671)
Të ardhura nga tarifatat dhe komisionet, neto	2,466,054	1,982,909

Shërbimet e kleringut, shlyerjes dhe pagesave

Të ardhura të tilla krijohen kryesisht nga komisionet e transfertave, të cilat janë një nga burimet kryesore të të ardhurave të Grupit. Ai përfshin komisione të ndryshme të aplikuara për lloje të ndryshme klientësh, si individë, mikro, SME dhe klientë të korporatave, secili ka tarifën e veta specifike. Të ardhura të tilla njihen në momentin që transfertat porositet dhe përpunohet.

Komisionet e biznesit të kredisë

Të ardhurat e biznesit nga kreditë përbëhen vetëm nga komisionet që lidhen me produktet e huasë si tarifën e shlyerjes së parakohshme, tarifën e shlyerjes së vonuar, komisionet nga vlerësimi i kolateralit, komisioni për ndryshimin e kolateralit etj.

Shërbimet e Kujdestarisë

Grupi ofron shërbime të kujdestarisë për klientët e saj dhe hyn në ankande obligacionesh në emër të tyre kur një urdhër ngrihet. Bazuar në llojin e klientit dhe shumën e blerë, tarifën paguhen për shërbimin e ofruar.

Transaksionet e këmbimit valutor

Të ardhurat nga transaksionet e këmbimit valutor përfaqësojnë të ardhura nga tregtimi. Këto komisione ngarkohen nga klientët që kërkojnë nga Grupi të shkëmbejë valutë për ta. Të ardhura të tilla njihen në një moment kohor.

Të tjera

Në të ardhurat e tjera përfshihen të ardhurat e Administratës, të cilat përfaqësojnë tarifën e menaxhimit të aseteve dhe konsiderohen si të ardhura nga shërbimet e kryera për pensionet/fondet e investimeve në administrim. Këto të ardhura njihen me kalimin e kohës. Pothuajse e gjithë pjesa tjetër e të ardhurave të tjera përbëhet nga tarifën e ndërmjetësit të mbledhura nga shërbimet e sigurimit të ofruara për klientët. Banka është licencuar nga autoriteti i mbikëqyrjes financiare në Shqipëri për të ofruar shërbimet e ndërmjetësit të sigurimeve për klientët që e kërkojnë atë. Grupi punon me disa kompani sigurimesh si agjentë të tyre për të ofruar shërbime të tilla dhe mbledh një tarifë prej tyre çdo muaj.

3. HUMBJET TREGTARE NETO

në mijë LEK	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fitimet / (humbjet) neto të aktiveve dhe pasiveve financiare - vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	8,780	14,669
Letrat me vlerë të borxhit	8,780	14,669
Diferencat e këmbimit, neto	216,925	564,640
Totali	225,705	579,309

4. HUMBJE TË TJERA OPERATIVE, NETO

në mijë LEK	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Fitimet për mosnjohjen e aktiveve jo financiare	-	3,924
Të ardhurat neto nga qiraja nga aktivet materiale afatgjata për investim, duke përfshirë qiratë operative (pasurive të patundshme)	5,174	6,417
Të ardhura të ndryshme operative	35,796	37,241
Të ardhura të tjera operative	40,970	47,582
Shpenzime për kolateralët e riposeduara	(169,037)	(79,727)
Humbjet për mosnjohjen e aktiveve jo financiare	(1,858)	-
Shpenzimet alokimi për provigjoneve të tjera	(8,247)	(6,045)
Shpenzime të ndryshme operative	(107,113)	(93,300)
Shpenzime të tjera operative	(286,255)	(179,072)
Totali	(245,285)	(131,490)

Vlera e shpenzimeve të ndryshme operative lidhet me rezultatin nga aktivitetet e tjera operative të bankës. Më së shumti lidhet me shpenzimet nga përfundimi i kontratës së qirasë së ndërtesës, shpenzimet humbje nga fshirja e debitorëve, humbjet nga mashtrimi, humbjet nga operacionet në cash, humbjet në transaksionet ATM-POS. Gjatë vitit 2021 ka një rritje të shpenzimeve të ndryshme operative për faktin se humbjet nga shitja e aktiveve të riposeduara janë 80 milionë lekë (2020: 43 milionë lekë).

5. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

në mijë LEK	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Shpenzime stafi	(2,393,924)	(2,483,495)
Shpenzime të tjera administrative	(2,066,118)	(1,838,994)
Amortizimi i mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	(709,959)	(770,307)
Totali	(5,170,001)	(5,092,796)

5.1 Shpenzime stafi

në mijë LEK	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga	(2,062,591)	(2,147,980)
Kostot e sigurimeve shoqërore dhe taksat e lidhura me stafit	(233,616)	(233,935)
Shpenzime të tjera shoqërore vullnetare	(42,080)	(23,308)
Probabiliteti i mospagesës paraqet mundësitë që një huamarrës të mos përmbushë detyrimet e tij financiare gjatë dymbëdhjetë muajve të ardhshëm ose përgjatë kohës së mbetur të detyrimit. Në përgjithësi, probabiliteti i mospagimit përgjatë jetës llogaritet duke përdorur probabilitetin rregullator dymbëdhjetë mujor të mospagimit, duke zbritur çdo rregullim të matur, si pikënisje. Më pas përdoren metoda të ndryshme statistikore për të gjeneruar një vlerësim se si do të zhvillohet profili i mospagimit nga pika e njohjes fillestare përgjatë gjithë jetës së huasë ose portofolit të huave. Profili i pashlyer ose me vonesë në shlyerje bazohet në të dhënat historike dhe funksionet parametrike. Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar profilin e shumave të huadhënies së pashlyer dhe këto mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- Klientët e korporatave, financimi i projekteve dhe institucionet financiare: Profili i mospagimit krijohet duke përdorur një qasje të regresionit parametrik të mbijetesës (Weibull). Informacioni i mëtejshëm përfshihet në probabilitetin e mospagimit duke përdorur modelin me një faktor Vasicek. Rregullimi i normës së mospagimit bazohet në metodologjinë Kaplan Maier me rregullim të tërheqjes.
- Huadhënia në retail dhe kreditë hipotekore: Profili i mospagimit krijohet duke përdorur regresionin parametrik të mbijetesës në kornizat konkurruese të rrezikut. Informacioni i mëtejshëm përfshihet në probabilitetin e mospagimit duke përdorur modelet satelitore.
- Qeverite Qendrore, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimeve dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive: Profili i mospagesës krijohet duke përdorur një qasje të matricës së tranzicionit. Informacioni i mëtejshëm përfshihet në probabilitetin e mospagimit duke përdorur modelin me një faktor Vasicek.

Në raste të caktuara ku disa inpute nuk janë plotësisht të disponueshme, grupimi, mesatarizimi dhe krahasimi i të dhënave përdoret për llogaritjen.

Humbja e mospagesës (HM)

Humbja në rast mospagese, paraqet pritshmerinë që ka Grupi për shkallën e humbjes lidhur me ekspozimin e mospagimit. Kjo humbje varion sipas produktit apo palës së tretë nga e cila rrjedh. Humbja nga mospagimi shprehet si përqindje për njësi ekspozimi në kohën e mospagimit. Ajo llogaritet në bazë 12 mujore ose përgjatë gjithë jetës, ku humbja nga mospagimi 12-mujor është përqindja e humbjes që pritët të pësohet nëse ndodh mospagimi në 12 muajt e ardhshëm dhe humbja nga mospagimi gjatë jetës është përqindja e humbjes që pritët të pësohet nëse mospagimi ndodh gjatë jetës së mbetur.

Modele të ndryshme janë përdorur për të vlerësuar humbjen në rast mospagese të kredisë së mbetur, të cilat mund të grupohen sipas kategorive të mëposhtme:

- Modeli shtetëror: humbja në rast mospagimi është përlllogaritur duke përdorur burimet e tregut, pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për humbjet për segmentin shtetëror. Metoda bazohet në ngjarje të jashtme të mospagesës në sektorin shtetëror për periudhën midis 1998 dhe 2015. Vetëm GDP rezultoi të kishte një ndikim të rëndësishëm.
- Për klientët korporata, financimet e projekteve, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, shoqëritë e sigurimeve, humbja në rast mospagese krijohet duke aktualizuar fluksat e mjeteve monetare që duhet të ëhuamarrësit gjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore ose gjatë gjithë jetës. Kur është e rëndësishme, supozimet e ripagimit / ri-financimit të hershëm konsiderohen gjithashtu në llogaritje.
- Për produktet me shumë pagesa, ekspozimi i mospagimit parashikohet duke marrë llogarinë aktuale të tërheqjeve dhe duke shtuar një faktor konvertimi kreditor, i cili lejon tërheqjet e pritura të mbetura deri në kohën e shlyerjes. Marzhet rregullatorë hiqen nga faktori i konvertimit të kredisë. Në rrethana të kufizuara ku disa të dhëna nuk janë plotësisht në dispozicion, krahasimi i të dhënave përdoret për llogaritjen.

Faktori i zbritjes (D)

Në përgjithësi, aktivet financiare dhe aktivet jashtë pasqyrës së pozicionit financiar, të cilat nuk janë leasing ose aktiv financiar i zhvlerësuar që në blerje ose në krijim (POCI), norma e skontimit e përdorur në llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë është norma efektive e interesit ose një përafrim i saj.

Llogaritja

Për kreditë në Fazën 1 dhe 2, humbja e pritshme e kredisë është produkti i PM, HM dhe EM shumëfish i probabilitetit për të mos mospaguar para periudhës kohore të konsideruar. Ky i fundit shprehet me funksionin e mbijetesës S. Kjo llogarit vlerat e ardhshme të humbjeve të pritshme kreditor të cilat më pas zbriten në datën e raportimit dhe përmblihen. Vlerat e llogaritura të humbjeve të pritshme të kredisë peshohen më pas sipas skenarit të ardhshëm.

Janë përdorur modele të ndryshme për të vlerësuar provizionet në Fazën 3, dhe këto mund të grupohen në kategoritë

26. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

e mëposhtme:

- Klientët e korporatave, financimet e projekteve, institucionet qeveritare, institucionet financiare, qeveritë lokale dhe rajonale, kompanitë e sigurimit dhe sipërmarrjet e investimeve kolektive: Vlerësimi i fluksit të mjeteve monetare të ardhshme për provizionet e Fazës 3 bëhet nga menaxherët me eksperiencë dhe llogaritja e provizioneve bëhet nga sistemi ynë lokal.
- Për kreditë me pakicë, zhvlerësimet e Fazës 3 përcaktohen për shumicën e njësive të Grupit duke llogaritur vlerësimin më të mirë statistikor të derivuar të humbjes së pritshme të rregulluar për kostot indirekte.

Karakteristikat e përbashkëta të rrezikut kreditor

Vlerësimi i rritjes së konsiderueshme i rrezikut kreditor dhe llogaritja e humbjeve të pritshme kreditore, të dyja përfshijnë parashikimet për kushtet e ardhshme. Grupi ka kryer analiza historike dhe ka identifikuar variablat kryesorë ekonomikë që ndikojnë në rrezikun e kredisë dhe humbjet e pritura të kreditit për çdo portofol.

Këto variabla ekonomikë dhe ndikimi i tyre lidhur me probabilitetin e mospagimit, humbja e mospagimit dhe ekspozimi i mospagimit varion nga lloji i kategorisë. Parashikimet e këtyre variablave ekonomike (skanari bazë ekonomik) sigurohen nga RBI Raiffeisen Research në baza tremujore dhe japin pikëpamjen më të mirë të ekonomisë gjatë tre viteve të ardhshme. Informacionet e mëtejshme përfshijnë gjithashtu orën e kredisë që përdoret për përmirësimin e regresionit, i cili riprodhon gjendjen aktuale të ciklit të kredisë dhe rrjedhjen e dukshme të zhvillimit të ciklit të kredisë. Pas tre vjetësh, për të projektuar variablat ekonomikë për jetëgjatësinë e plotë të secilit instrument, është përdorur një përfaqje e kthimit mesatar, që do të thotë se variablat ekonomikë kanë tendencë të jenë një normë mesatare afatgjatë ose një mesatare afatgjatë norma e rritjes deri në maturim. Ndikimi i këtyre variablave ekonomikë në probabilitetin e mospagimit, humbjes së mospagimit dhe ekspozimit të mospagimit është përcaktuar duke kryer regresionin statistikor për të kuptuar ndikimin e ndryshimeve që këto variabla kanë pasur historikisht në normat e mospagesës dhe në komponentët e humbjes në rast mospagimi dhe në ekspozimin në rast mospagese.

Përveç skenarit bazë ekonomik, Raiffeisen Research, një departament i njësive ekonomike mëmë, vlerëson gjithashtu një skenar optimist dhe një pesimist për të siguruar kapjen e jo-linearitetit. Grupi ka arritur në përfundimin se tre ose më pak skenarë arrijnë të identifikojnë në mënyrë të përshtatshme jo-linearitetin. Gjykimi i ekspertëve për rreziqet josistematike është zbatuar edhe në këtë proces në nivel të Raiffeisen Research në koordinim me menaxhimin e rrezikut të Grupit, duke rezultuar në rregullime selektive të skenarëve optimistë dhe pesimistë.

Ashtu si me çdo parashikim ekonomik, projeksionet dhe mundësitë e ndodhjes i nënshtrohen një shkalle të lartë pasigurie të qenësishme dhe për këtë arsye rezultatet aktuale mund të jenë dukshëm të ndryshme nga ato të parashikuara. Grupi i konsideron këto parashikime se përfaqësojnë vlerësimin e tij më të mirë të rezultateve të ardhshme dhe mbulojnë çdo jo-linearitet dhe asimetri të mundshme brenda portofoleve të ndryshme të Grupit.

Për zhvillimin e një modeli makroekonomik, u përdorën një sërë variablash makroekonomikë përkatës. Modeli i përdorur është një model regresioni linear me synimin për të shpjeguar ndryshimet ose nivelin e normës së mospagimit. Llojet e mëposhtme të makro-variablave u konsideruan si nxitës të ciklit të kredisë: rritja reale e PBB-së, norma e papunësisë, norma 3-mujore e tregut të parasë, yield-i i obligacioneve shtetërore 10-vjeçare, indeksi i çmimeve të banesave, normat e këmbimit valutor dhe norma e inflacionit të IHÇK-së. Për çdo vend (ose portofol në rast ekspozimi me pakicë), një grup përkatës përcaktohet bazuar në aftësinë për të shpjeguar normat e mospagimit të vëzhguara përgjatë kohës. Nëpërmjet ciklit, PM -të mbivendosen me rezultatet e modelit makroekonomik për të pasqyruar gjendjen aktuale dhe të pritshme të ekonomisë. Për HM, modeli makro zbatohet në normat themelore të kurbës d.m.th., një perspektivë pozitive makroekonomike rrit normat e kurbës dhe kjo redukton HM. Për ekspozimet me pakicë, HM është modeluar në një mënyrë të ngjashme me normën e mospagimit drejtpërdrejt ose nëpërmjet komponentëve të tillë si norma e kurbës, kurba e humbjeve, si dhe humbja e parikuperueshme. HM-të mesatare afatgjata janë mbivendosur me rezultatet e modeleve makro për të pasqyruar gjendjen aktuale dhe të pritshme të ekonomisë. Ponderimet e caktuara për secilin skenar në fund të vitit raportues janë si më poshtë: 25 për qind optimistë, 50 për qind skenarë bazë dhe 25 për qind skenarë pesimistë. Këto peshime u ruajtën dhe nuk u përdorën skenarë të mëtejshëm si rezultat i pandemisë COVID-19.

Pas rritjes së fortë, COVID-19 është përsëri në rritje. Duke qenë se vaksinat janë ende nën nivelet e dëshiruara, rreziqet për një dobësim tjetër ekonomik gjatë dimrit 2021/2022 janë rritur. Rimëkëmbja e fortë në tre tremujorët e parë të 2021 do të ngadalësohet në vitin 2022, por rritja ekonomike do të mbetet mbi mesataren për shumicën e vendeve. Në skenarin bazë supozohet se shumica e vendeve do të arrijnë nivelet e para krizës në vitin 2022. Krahas pandemisë, ndërprerjet e zinxhirit të furnizimit dhe inflacioni i lartë i energjisë janë një rrezik për rritjen ekonomike.

Rimëkëmbja e fortë e ekonomisë është turbulluar nga ngjarjet e fundit gjeopolitike në Ukrainë. Ndikimi i drejtpërdrejtë i luftës pritet të jetë i ulët për shkak të ndërlidhjeve të kufizuara tregtare midis 3 vendeve më të përfshira në konflikt. Megjithatë, goditja indirekte në çmimet e naftës, duke ushqyer drejtpërdrejt inflacionin dhe, rrjedhimisht, konsumin privat po ndihet tashmë nga popullsia. Prandaj, ne kemi ulur projeksionin tonë fillestar për ekonominë prej 4.4% në një rritje më të moderuar prej 3.4% në 2022. Konsumi privat, që supozohej të ishte shtytësi i ekonomisë në vitin 2022, pritet të kufizohet nga një normë më e lartë inflacioni. dhe një sezon turistik më të dobët krahasuar me supozimet fillestare.

Rregullimet e pas-modelit dhe faza e mbledhjes

26. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

Mbivendosjet dhe faktorë të tjerë rreziku

Në situatat kur parametrat ekzistues të të dhënave, supozimet dhe modelimi nuk mbulojnë të gjithë faktorët përkatës të rrezikut, rregullimet pas modelit dhe faktorët shtesë të rrezikut janë llojet më të rëndësishme të mbivendosjeve. Ky është përgjithësisht rasti kur ka rrethana të përkohshme, kufizime kohore për të përfshirë në mënyrë adekuate informacionin e ri përkatës në vlerësimin ose ri-segmentimin e portofolit dhe nëse kreditë individuale brenda një portofoli kredie zhvillohen ndryshe nga sa pritej fillimisht. Për shkak të situatës aktuale pandemike, është e nevojshme të pasqyrohen rreziqe shtesë në zhvlerësim.

Të gjitha këto rregullime miratohen nga Komiteti i Rrezikut të Grupit (GRC).

Për modelet qendrore në segmentin e korporatave, rreziku shtesë është konsideruar duke përdorur faktorët e rrezikut, ndërsa në segmentin lokal të shitjes me pakicë, rreziqet janë aplikuar në krye të modeleve. Për ekspozimet me pakicë, rregullimet pas modelit janë llojet kryesore të mbivendosjeve të aplikuara për llogaritjen e humbjeve të pritshme të kredisë. Në përgjithësi, rregullimet pas modelit janë vetëm një zgjidhje e përkohshme për të shmangur shtrembërimet e mundshme. Drejtimi ka vlerësuar njohjen dhe llogaritjen e rregullimeve pas modelit deri në 2023. Mbivendosjet përkatëse për vitin 2021 janë paraqitur në tabelën më poshtë dhe të ndara sipas kategorive përkatëse.

December 31, 2021	HPK e mod- eluar 000 lekë	Rregullimet Pas-modelit						Total
		Lidhur me COVID-19		Të tjera		Total		
Banka qendrore	154	-	0%	-	0%	-	0%	154
Qeveria	28,202	-	0%	-	0%	-	0%	28,202
Bankat	559	-	0%	-	0%	-	0%	559
Korporatat e tjera financiare	34	-	0%	-	0%	-	0%	34
Korporatat jofinanciare	698,862	212,336	30.4%	-	0%	212,336	30.4%	911,198
Individët	816,628	247,066	30.3%	-	0%	247,066	30.3%	1,063,694
Total	1,544,438	459,402	29.7%	-	0%	459,402	29.7%	2,003,840

Rregullimet pas modelit rezultuan në provizione shtesë të fazës 1 dhe 2 prej 459,402 mijë lekësh, nga të cilat 459,402 mijë lekë janë të lidhura me COVID-19.

Rregullimet pas modelit

Rregullimet pas modelit të lidhura me COVID-19 pasqyruan ndikimin kolektiv në sektorët që u goditën më shumë nga pandemia: turizmi, hotelet, industritë e ardhshme, si dhe automobilat, udhëtimet ajrore, nafta, gazi, pasuritë e paluajtshme dhe disa industry të mallrave të konsumit. Efektet ishin për shkak të rënies së kërkesës, ndërprerjeve të zinxhirit të furnizimit dhe masave për kontrollimin e krizës. Rregullimet e lidhura pas modelit përfshijnë një vlerësim cilësor të ekspozimeve për rritjen e pritshme të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe transferimin e tyre të mëvonshëm nga Faza 1 në Fazën 2. Kriteret për identifikimin e ekspozimeve të tilla bazoheshin kryesisht në industritë e listuara më sipër (për NVM-të) dhe industritë e punësimit (për familjet) dhe më tej, kur është e nevojshme, me informacion në lidhje me zbatimin e masave specifike të kufizimit. Rregullimet pas modelit anulohen pasi rreziqet janë materializuar duke transferuar llogaritë e arkëtueshme të prekura në Fazën 3 ose nëse rreziqet e pritshme nuk materializohen.

Në vitin 2021, rregullimet pas modelit të COVID-19 për klientët e korporatave u zëvendësuan me metodologjinë më të diferencuar të faktorit të rrezikut të përshkruar më poshtë. Gjithashtu ka nisur edhe reduktimi gradual i rregullimeve të modeleve të lidhura me COVID-19 për familjet dhe kjo pritet të përfundojë në mesin e vitit 2022 në varësi të masave kufizuese dhe specifike të tjera të vendosura nga qeveria. Llogaritë ose nuk do të jenë paguar deri në këtë kohë ose nuk do të konsiderohen më si rrezik i shtuar kredie dhe rregullimi do të anulohet.

Faktorë të tjerë rreziku

26. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

Për klientët e korporatave, efektet shtesë të humbjes së pritshme të kredisë janë ndërtuar në humbjet e pritshme të kredisë të modeluara me anë të një matrice industrie, specifike të vendit ose, nëse është e nevojshme, me anë të faktorëve të tjerë të veçantë të rrezikut. Në krye të pamjes ekzistuese specifike të vendit, ne përdorim një diferencim të bazuar në industri për të moduluar më tej parametrat e rrezikut. Kjo matricë e industrisë kombinon një gjendje afatshkurtër të industrisë brenda ciklit ekonomik dhe rrugën e rimëkëmbjes në një horizont trevjeçar. Për shembull, për hotelet, PBB-ja përcakton perspektivën makroekonomike, ndërsa matrica e industrisë tregon një skenar pesimist dhe, në krye të kësaj, zënia e faktorit të rrezikut të veçantë nxit nivelin e ngritur të zhvlerësimeve të Fazës 2. Një komponent tjetër i informacionit të ardhshëm është vonesa kohore e fluksit hyrës ndaj ekspozimit jofunksional dhe Faza 3 për shkak të masave kufizuese dhe mbështetëse. Efekti i njëhershëm i përdorimit të metodologjisë më të diferencuar ka kompensuar plotësisht mbivendosjen e mëparshme.

Faktorë të tjerë rreziku

Supozimet më të rëndësishme që ndikojnë në ndjeshmërinë e lejimit të humbjeve të pritshme të kredisë janë si më poshtë:

- Produkti i brendshëm bruto (të gjitha portofolet)
- Norma e papunësisë (të gjitha portofolet)
- Norma afatgjata e obligacioneve të qeverisë (kryesisht portofole të shitjes jo me pakicë)

Në tabelën e mëposhtme jepet një krahasim midis zhvlerësimit të akumuluar të raportuar për humbjet e pritshme të kredisë për aktivet financiare në Nivelin 1 dhe 2 (peshuar nga 25 për qind sipas skenarit optimist, 50 për qind sipas skenarit bazë dhe 25 për qind sipas skenarit pesimist) dhe pastaj çdo skenar i ponderuar me 100 për qind më vete. Skenarët optimistë dhe pesimistë nuk pasqyrojnë raste ekstreme, por mesataren e skenarëve që shpërndahen në këto raste. Ky informacion është dhënë për qëllime ilustruese.

2021	31/12/2021	100%	100%	100%
Në mijë Lekë	(25/50/25%)	Optimist	Bazë	Pesimist
Zhvlerësimi i akumuluar (Niveli 1 & 2)	2,003,782	1,937,589	1,991,959	2,093,622
2020	31/12/2020	100%	100%	100%
Në mijë Lekë	(25/50/25%)	Optimist	Bazë	Pesimist
Zhvlerësimi i akumuluar (Niveli 1 & 2)	1,474,619	1,282,419	1,480,324	1,655,408

26. HUMBJET E PRITSHME TË KREDISË (VAZHDIM)

Fshirjet nga bilanci

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit fshihen (pjesërisht ose plotësisht) kur nuk ka mundësi të arsyeshme për tu rikuperuar. Kjo ndodh kur huamarrësi nuk ka më të ardhura nga operacionet dhe vlerat kolaterale nuk mund të gjenerojnë flukse të mjaftueshme të mjeteve monetare për të shlyer shumat që janë subjekt i fshirjes nga bilanci. Për ekspozimin e shoqërive në falimentim, kreditë zhvlerësohen në vlerën e kolateralit nëse shoqëria nuk gjeneron flukse monetare nga aktiviteti i tij operativ. Biznesi me pakicë merr në konsideratë faktorët cilësorë. Në rastet kur nuk është bërë pagesa për një vit, shumat e papaguara çregjistrohen kurse aktivet e zhvlerësuara mund të vazhdojnë të jenë subjekt i veprimeve përmbarimore.

Për ekspozimin e shoqërive të vlerësuara si biznes që nuk pritet të zbatojnë parimin e vijmësisë, kreditë janë zhvlerësuar në vlerën e kolateralit nëse shoqëria nuk gjeneron flukse të mjeteve monetare nga biznesi i saj operacional. Biznesi me pakicë merr në konsideratë faktorët cilësorë. Në rastet kur nuk janë kryer pagesa për një vit, shumat e papaguara janë fshirë këtu. Shumat kontraktuale të papaguara të aktiveve financiare të cilat janë fshirë gjatë periudhës raportuese dhe që ende i nënshtrohen veprimtarisë së përmbarimit janë jomateriale/ janë në mijë lekë.

27. EKSPOZIMI BRUTO SIPAS NIVELEVE

Portofoli i kredisë i Grupit është shumë i larmishëm në aspektin e tipit të klientëve, rajonit gjeografik dhe industrisë. Përqendrimit e emrave të vetëm janë gjithashtu të administruara në mënyrë aktive (bazuar në konceptin e klientëve të lidhur të grupit) me kufizime dhe raportim të rregullt. Si pasojë, përbërja e portofolit është e lartë. Tabela e mëposhtme tregon aktivet financiare - koston e amortizuar bazuar në palët dhe Nivelet përkatëse. Kjo tregon fokusin e Grupit në shoqëritë jofinanciare dhe individët:

2021 Në mijë Lek	Vlera kontabël bruto			Vlera e akumuluar			HPK Raporti i mbulimit		
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Banka qendrore	6,035,185	-	-	(55)	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Institucionet qeveritare	76,797,981	70	-	(28,201)	(1)	-	0.04%	0.81%	0.00%
Bankat	34,312,527	-	-	(546)	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Korporata të tjera financiare	6,438	-	-	-	-	-	0.01%	0.00%	0.00%
Korporatat jofinanciare	56,647,711	5,395,994	7,134,616	(450,113)	(543,532)	(5,666,222)	0.79%	10.07%	79.42%
Individët nga te cilat kredi hipotekore	41,863,213	2,858,918	2,726,925	(377,566)	(554,155)	(1,999,801)	0.90%	19.38%	73.34%
	18,202,467	1,533,993	391,885	(165,184)	(258,072)	(256,224)	0.91%	16.82%	65.38%
Total	215,663,055	8,254,982	9,861,541	(856,481)	(1,097,688)	(7,666,023)	0.40%	13.30%	77.74%
2020 Në mijë Lek	Vlera kontabël bruto			Vlera e akumuluar			HPK Raporti i mbulimit		
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Banka qendrore	6,180,755	-	-	(293)	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Institucionet qeveritare	51,169,744	-	-	(144,855)	-	-	0.28%	0.00%	0.00%
Bankat	29,191,990	-	-	(277)	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Korporata të tjera financiare	7,776	-	-	(2)	-	-	0.02%	0.00%	0.00%
Korporatat jofinanciare	36,726,134	11,266,311	9,677,001	(241,882)	(649,680)	(7,324,807)	0.66%	5.77%	75.69%
Individët nga te cilat kredi hipotekare	36,007,959	3,056,447	2,698,314	(442,186)	(556,129)	(1,912,032)	1.23%	18.20%	70.86%
	15,696,195	1,058,487	495,454	(209,354)	(200,792)	(314,343)	1.33%	18.97%	63.45%
Total	159,284,358	14,322,758	12,375,315	(829,495)	(1,205,809)	(9,236,839)	0.52%	8.42%	74.64%

Tabela e mëposhtme tregon detyrimet e kushtëzuara dhe angazhimet e tjera jashtë bilancit nga palët dhe nivelet. Kjo nxjerr në pah fokusin e Grupit ndaj shoqërive jofinanciare:

2020 Në mijë Lek	Vlera nominale			Provizionet për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9			Raporti i mbulimit HPK		
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Banka Qendrore	-	-	-	-	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Bankat	2,523,959	-	-	11	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Institucionet qeveritare	-	-	-	-	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Korporata të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Korporatat jo-financiare	17,905,415	1,218,125	70,073	68,519	17,904	69,865	-0.38%	-1.47%	-99.70%
Individë	3,679,702	25,364	24,490	20,059	2,063	20,627	-0.55%	-8.13%	-84.23%
Totali	24,109,076	1,243,489	94,563	88,589	19,967	90,492	-0.37%	-1.61%	-95.70%
2020 Në mijë Lek	Vlera nominale			Provizionet për zërat jashtë bilancit sipas SNRF 9			Raporti i mbulimit HPK		
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Banka Qendrore	-	-	-	-	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Bankat	1,845,787	-	-	3	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Institucionet qeveritare	-	-	-	-	-	-	0.00%	0.00%	0.00%
Korporata të tjera financiare	77,420	-	-	955	-	-	-1.23%	0.00%	0.00%
Korporatat jo-financiare	13,845,773	2,339,667	20,414	28,393	24,728	20,219	-0.21%	-1.06%	-99.04%
Individë	3,603,767	49,586	33,423	22,014	2,353	26,266	-0.61%	-4.75%	-78.59%
Totali	19,372,747	2,389,253	53,837	51,365	27,081	46,485	-0.27%	-1.13%	-86.34%

28 EKSPozIMI BRUTO SIPAS NIVELEVE VAZHDIM

Tabela në vijim tregon vlerën kontabël bruto dhe zhvlerësimin e aktiveve financiare - koston e amortizuar që janë zhvendosur nga matja në bazë të humbjeve të pritshme 12-mujore në matje në bazë të humbjeve të pritshme gjatë jetës ose anasjelltas:

2021 Në mijë Lek	Vlera kontabël bruto		Zhvlerësimet		Raporti i mbulimit HPK	
	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës
Transferimi nga HPK 12 mujore në HPK përgjatë gjithë jetës	-	-	-	-	-	-
Korporatat jo-financiare	(1,837,526)	1,837,526	(59,811)	162,399	3.25%	8.84%
Individë	(1,354,124)	1,354,124	(39,910)	367,811	2.95%	27.16%
Transferimi nga HPK përgjatë gjithë jetës në HPK 12 mujore	-	-	-	-	-	-
Korporatat jo-financiare	5,099,327	(5,099,327)	72,985	(256,549)	1.43%	5.03%
Individë	1,036,443	(1,036,443)	20,069	(236,303)	1.94%	22.80%

2020 Në mijë Lek	Vlera kontabël bruto		Zhvlerësimet		Raporti i mbulimit HPK	
	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës
Transferimi nga HPK 12 muaj në HPK përgjatë gjithë jetës	-	-	-	-	-	-
Korporatat jo-financiare	(5,935,976)	5,935,976	(57,387)	340,119	0.97%	5.73%
Individë	(2,288,328)	2,288,328	(50,063)	623,686	2.19%	27.26%
Transferimi nga HPK përgjatë gjithë jetës në HPK 12 muaj	-	-	-	-	-	-
Korporatat jo-financiare	1,019,667	(1,019,667)	7,366	(30,220)	0.72%	2.96%
Individë	1,057,013	(1,057,013)	42,082	(220,128)	3.98%	20.83%

29. ZHVLERËSIMI

Tabela e mëposhtme tregon zhvlerësimin e kredive dhe obligacioneve në kategorinë e matjes së aktiveve financiare-koston e amortizuar dhe aktivet financiare.

Në mijë Lek	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI	Totali
	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës		
1 janar 2021	829,526	1,205,775	7,335,241	1,901,598	11,272,141
Rritja për shkak të vendit të origjinës dhe të blerjes	171,169	9,210	129,072	-	309,451
Zvogëlimi për shkak të mosnjohjes	(14,590)	(16,494)	(925,745)	(11,226)	(968,055)
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut të kredisë (neto)	(129,057)	(85,521)	657,491	(320,071)	122,842
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të vlerësimit në metodologjinë e institucionit	-	-	-	-	-
Zvogëlimi i zbritjes për shkak të fshirjeve	(569)	(15,284)	(1,099,758)	(576)	(1,116,187)
31 dhjetor 2021	856,479	1,097,686	6,096,301	1,569,725	9,620,192

Në mijë Lek	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	POCI	Totali
	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës		
1 janar 2020	802,280	675,644	7,143,642	1,800,612	10,422,178
Rritja për shkak të vendit të origjinës dhe të blerjes	113,924	43,369	156,302	-	313,595
Zvogëlimi për shkak të mosnjohjes	(35,629)	(51,871)	(600,190)	-	(687,690)
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut të kredisë (neto)	(50,772)	347,754	1,361,233	103,632	1,761,847
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të vlerësimit në metodologjinë e institucionit	-	201,442	(138,159)	-	63,283
Zvogëlimi i zbritjes për shkak të fshirjeve	(309)	(10,529)	(587,588)	(2,646)	(601,072)
31 dhjetor 2020	829,494	1,205,809	7,335,240	1,901,598	11,272,141

Tabela e mëposhtme tregon zhvillimin e provizioneve për angazhimet e huasë, garancitë financiare dhe angazhimet e tjera:

Në mijë Lek	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	
1 janar 2021	51,364	27,081	46,485	124,930
Rritja për shkak të vendit të origjinës dhe të blerjes	70,926	9,355	93,555	173,836
Zvogëlimi për shkak të mosnjohjes	(9,726)	(3,919)	(38,118)	(51,763)
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut të kredisë (neto)	(23,975)	(12,550)	(11,430)	(47,955)
Ndryshime për shkak të përditësimit të metodologjisë së institucionit	-	-	-	-
31 dhjetor 2021	88,589	19,967	90,492	199,048

29 ZHVLERËSIMI (VAZHDIM)

Në mijë Lek	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
	12 muaj HPK	HPK përgjatë gjithë jetës	HPK përgjatë gjithë jetës	
1 janar 2020	53,736	8,956	19,206	81,898
Rritja për shkak të origjinimit dhe të blerjes	43,977	13,483	-	57,460
Zvogëlimi për shkak të mosnjohjes	(17,977)	(11,795)	-	(29,772)
Ndryshimet për shkak të ndryshimit të rrezikut të kredisë (neto)	(32,637)	17,478	28,671	13,512
Ndryshime për shkak të përditësimit të metodologjisë së institucionit	4,265	(1,041)	(1,392)	1,832
31 dhjetor 2020	51,364	27,081	46,485	124,930

30. STATUSI "ME VONESË"

Në tabelën në vijim janë paraqitur kërkesat dhe borxhet në vonesë të matur me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse:

2021	Vlera kontabël								
	Aktive në vonesë pa rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare (Niveli 1)			Aktive në vonesë me rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare por jo të zhvlerësuara (Niveli 2)			Aktive me vonesë të zhvlerësuara (Niveli 3)		
Në mijë Lek	≤ 30 ditë	> 30 ditë	> 90 ditë	≤ 30 ditë	> 30 ditë	> 90 ditë	≤ 30 ditë	>30 ditë	>90 ditë
Korporata jo financiare	2,335,664	-	-	678,980	143,885	-	633,248	45,766	431,388
Individë	592,504	-	-	158,051	217,616	-	59,015	28,757	413,860
Totali	2,928,168	-	-	837,031	361,501	-	692,263	74,523	845,248

2020	Vlera kontabël								
	Aktive në vonesë pa rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare (Niveli 1)			Aktive në vonesë me rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare por jo të zhvlerësuar (Niveli 2)			Aktive me vonesë të zhvlerësuara (Niveli 3)		
Në mijë Lek	≤ 30 ditë	> 30 ditë	> 90 ditë	≤ 30 ditë	> 30 ditë	> 90 ditë	≤ 30 ditë	>30 ditë	>90 ditë
Korporata jo financiare	995,292	-	-	1,704,805	995,324	-	384,398	48,129	1,631,753
Individë	557,700	-	-	260,038	197,749	-	119,676	20,592	386,633
Totali	1,552,992	-	-	1,964,843	1,193,073	-	504,074	197,253	2,018,386

31. NDARJA SIPAS MATURITETIT TË MBETUR

Aktive	Aktivet afatshkurtra			Aktivet Afatgjata	
	Pa afat	Deri në 3 muaj	Më shumë se 3 muaj, deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
2021 Në mijë Lek					
Arka, banka qendrore dhe llogari të tjera pa afat	22,165,330	3,241	-	-	-
Aktivet financiare - kosto e amortizuar	22,227	67,772,201	41,883,982	91,525,309	32,575,859
Aktivet financiare - vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	-	889	11,333	-	-
Aktive të tjera	-	22,505	-	-	-
Totali	22,187,557	67,798,836	41,895,315	91,525,309	32,575,859
Detyrime	Detyrime afatshkurtra			Detyrimet afatgjata	
2021 Në mijë Lek	Pa afat	Deri në 3 muaj	Më shumë se 3 muaj, deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Detyrime financiare - kosto e amortizuar	197,563,843	15,769,142	26,889,031	1,434,195	378,484
Detyrime të tjera	61,726	213,125	-	-	-
Totali	197,625,569	15,982,267	26,889,031	1,434,195	378,484
Aktive	Aktivet afatshkurtra			Aktivet Afatgjata	
2020 Në mijë Lek	Pa afat	Deri në 3 muaj	Më shumë se 3 muaj, deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Arka, banka qendrore dhe llogari të tjera pa afat	37,754,061	3,537,118	-	-	-
Aktivet financiare - kosto e amortizuar	16,148	49,022,952	38,875,860	76,759,120	21,161,363
Aktivet financiare - vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes	-	1,278	3,737	-	-
Aktive të tjera	-	24,604	-	-	-
Totali	37,770,209	49,048,834	38,879,597	76,759,120	21,161,363
Detyrime	Detyrime afatshkurtra			Detyrimet afatgjata	
2019 Në mijë Lek	Pa afat	Deri në 3 muaj	Më shumë se 3 muaj, deri në 1 vit	Më shumë se 1 vit, deri në 5 vjet	Më shumë se 5 vjet
Detyrime financiare - kosto e amortizuar	159,716,931	14,642,434	30,439,830	1,231,831	215,571
Detyrime të tjera	21,415	171,138	0	0	0
Totali	159,738,346	14,813,572	30,439,830	1,231,831	215,571

32. VOLUMET NË MONEDHË TË HUAJ

Në mijë Lek	31/12/2021	31/12/2020
Aktivët	124,316,775	98,200,885
Detyrimet	111,905,726	84,878,975

Për detaje të mëtejshme mbi ekspozimet në valutë dhe analizën e ndjeshmërisë, referojuni Shënimit "36 Rreziku i Tregut" më poshtë.

ADMINISTRIMI I RREZIKUT

Administrimi aktiv i rrezikut është një kompetencë thelbësore e Grupit. Për të identifikuar, matur dhe administruar në mënyrë efektive rreziqet, Grupi vazhdon të zhvillojë sistemin gjithëpërfshirës të administrimit të rrezikut. Administrimi i rrezikut është një pjesë integrale e administrimit të përgjithshëm të bankave. Kryesisht, përveç kërkesave ligjore dhe rregullative, ai merr parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të biznesit të Grupit dhe rreziqet që rezultojnë. Raporti i rrezikut përshkruan parimet dhe organizimin e administrimit të rrezikut dhe përshkruan ekspozimin aktual të rrezikut në të gjitha kategoritë e rrezikut material.

33. PARIMET E ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Grupi ka një sistem të parimeve dhe procedurave të rrezikut në vend për matjen dhe monitorimin e rrezikut, i cili synon kontrollin dhe administrimin e rreziqeve materiale në Grup. Politikat e rrezikut dhe parimet e administrimit të rrezikut janë të përcaktuara nga Bordi Drejtues. Parimet përfshijnë politikat e mëposhtme të rrezikut:

- Administrimi i integruar i rrezikut: Kredia, vendi, tregu, likuiditeti dhe rreziqet operacionale administrohen si rreziqe kryesore në bazë të Grupit. Për këtë qëllim, këto rreziqe maten, kufizohen, grumbullohen dhe krahasohen me kapitalin e mbulimit të rrezikut në dispozicion.
- Planifikimi i vazhdueshëm: Strategjitë e rrezikut dhe kapitali i rrezikut rishikohen dhe miratohen gjatë procesit të buxhetimit dhe planifikimit njëvjeçar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit të përqëndrimeve të rrezikut.
- Kontrolli i pavarur: Mirëmbahet një personel i qartë dhe ndarja organizative midis veprimeve të biznesit dhe të gjitha aktiviteteve të administrimit të rrezikut ose kontrollit të rrezikut.
- Kontrolli "ex ante" dhe "ex post": Rreziqet maten vazhdimisht brenda fushës së shitjes së produktit dhe matjes së performancës së rregulluar nga rreziku. Në këtë mënyrë sigurohet që biznesi në përgjithësi kryhet vetëm nën konsideratat e kthimit të rrezikut dhe se nuk ka nxitje për të marrë rreziqe të larta.

Njësitë individuale të administrimit të rrezikut të Grupit zhvillojnë strategji të detajuara të rrezikut, të cilat përcaktojnë objektiva më konkrete të rrezikut dhe standarde specifike në përputhje me këto parime të përgjithshme. Strategjia e përgjithshme e rrezikut të Grupit rrjedh nga strategjia e biznesit e Grupit dhe kërkesa e rrezikut dhe shton aspekte të rëndësishme të rrezikut ndaj strukturës së planifikuar të biznesit dhe zhvillimit strategjik. Këto aspekte përfshijnë, për shembull, kufijtë strukturorë dhe objektivat e raportit të kapitalit që duhet të përmbushen në procesin e buxhetimit dhe në fushën e vendimeve të biznesit.

Objektivat më specifike për kategoritë individuale të rrezikut janë vendosur në strategjitë e detajuara të rrezikut. Për shembull, strategjia e rrezikut të kredisë e Grupit përcakton kufijtë e portofolit të kredisë për segmentet dhe përcakton autoritetin e miratimit të kredisë për aplikimet me limit.

34. ORGANIZIMI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT

Bordi Drejtues i Grupit siguron organizimin e duhur dhe zhvillimin e vazhdueshëm të administrimit të rrezikut. Ai vendos se cilat procedura duhet të përdoren për identifikimin, matjen dhe monitorimin e rreziqeve dhe merr vendime drejtuese sipas raporteve dhe analizave të rrezikut. Bordi Drejtues mbështetet në kryerjen e këtyre detyrave nga njësitë e administrimit të rrezikut të pavarur dhe komisionet e veçanta.

Funksionet e administrimit të rrezikut kryhen në nivele të ndryshme në Grup. Grupi zhvillon dhe zbaton konceptet përkatëse si institucioni i kreditit "mëmë". Njësitë e administrimit të rrezikut zbatojnë politikatat e rrezikut për llojet specifike të rrezikut dhe marrin vendime aktive drejtuese brenda buxheteve të miratuara të rrezikut për të arritur objektivat e vendosura në politikën e biznesit. Për këtë qëllim, ata monitorojnë rreziqet që rezultojnë nga përdorimi i mjeteve standarde të matjes dhe i raportojnë ato tek njësitë qendrore të administrimit të rrezikut nëpërmjet ndërfaqeve të përcaktuara. Divizioni qendror i Kontrollit të Rrezikut Bankar merr funksionin e kontrollit të pavarur të rrezikut të kërkuar nga ligji bankar. Përgjegjësitë e tij përfshijnë zhvillimin e një kuadri të gjerë të Grupit për administrimin e rrezikut të Grupit (duke integruar të gjitha llojet e rrezikut) dhe përgatitjen e raporteve të pavarura mbi profilin e rrezikut për Komitetin e Rrezikut të Bordit Mbikëqyrës, Bordit të Administrimit të Grupit dhe drejtuesve të njërive individuale të biznesit. Ai gjithashtu mat kapitalin e kërkuar të mbulimit të rrezikut për njësi të ndryshme të Grupit dhe llogarit përdorimin e buxheteve të kapitalit të rrezikut të alokuar në kuadrin e mjaftueshmërisë së kapitalit të brendshëm.

Komitetet e rrezikut

Komiteti i Rrezikut të Grupit është organi më i lartë vendimmarrës për të gjitha fushat e Grupit lidhur me rrezikun. Ai vendos për metodat e administrimit të rrezikut dhe për konceptet e kontrollit të përdorura përgjithësisht për Grupin dhe për nënndarjet kyçe dhe është përgjegjës për zhvillimin e vazhdueshëm dhe zbatimin e metodave dhe parametrave për përcaktimin e rrezikut dhe për përmirësimin e instrumenteve drejtuese. Kjo gjithashtu përfshin përcaktimin e rrezikut, buxhetet dhe kufizimet e ndryshme të rrezikut në nivelin e përgjithshëm të Grupit, si dhe monitorimin e situatës aktuale të rrezikut në lidhje me limitet e brendshme të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe rreziqet përkatëse. Ai miraton aktivitetet e administrimit të rrezikut dhe kontrollit (siç është shpërndarja e kapitalit të rrezikut) dhe këshillon Këshillin Drejtues në këto çështje. Komiteti i Aktiveve/Detyrimeve të Grupit vlerëson dhe administron strukturën e pozicionit financiar dhe rrezikun e likuiditetit dhe përcakton standardet për çmimet e transfertave të fondeve të brendshme. Në këtë kontekst ai luan një rol të rëndësishëm në planifikimin e financimit afatgjatë dhe mbrojtjes së normave të interesit strukturor dhe të kursit të këmbimit valutor.

Komiteti i Rrezikut të Tregut kontrollon rreziqet e tregut që rrjedhin instrumentet e mbajtura për shitje dhe mbajtura në maturim dhe përcakton kufijtë përkatës dhe proceset. Kryesisht, mbështetet në raportet e fitimit dhe humbjes, rreziqet e llogaritura, përdorimi i limitit, si dhe rezultatet e analizave të skenarit dhe testet e stresit në lidhje me rreziqet e tregut.

Komiteti i Kreditit përbëhen nga përfaqësues të stafit të zyrave shërbimit dhe të zyrave mbështetëse në varësi të llojit të klientit (klientët e korporatave, bankat, institucionet qeveritare dhe shitjet me pakicë). Komitetet përcaktojnë kriteret specifike të huadhënies për segmente të ndryshme të klientëve dhe marrin të gjitha vendimet e kredive në lidhje me ato segmente në lidhje me procesin e miratimit të kredisë (në varësi të vlerësimit dhe madhësisë së ekspozimit).

Komiteti i kredive me probleme është komiteti më i rëndësishëm në procesin e vlerësimit dhe vendimmarrjes në lidhje me huatë problematike. Komiteti përfshin kryesisht autoritetet vendimmarrëse; kryetari i tij është Drejtori Kryesor i Rrezikut (DKR) i Grupit. Anëtarët e mëtejshëm me të drejtë vote janë ata anëtarë të Bordit Drejtues përgjegjës për divizionet e konsumatorëve, Drejtori Financiar (CFO) dhe divizioni përkatës dhe menaxherët e departamenteve nga administrimi i rrezikut dhe administrimi i ekspozimeve të veçanta (të përfshira në proces).

Komiteti i Administrimit dhe Kontrollit të Rrezikut Operacionale të Grupit përbëhet nga përfaqësues të fushave të biznesit (klientët e shitjes me pakicë, të tregut dhe të korporatave) dhe përfaqësues të Pajtueshmërisë (duke përfshirë krimin financiar), Sistemin e Kontrollit të Brendshëm, Operacionet, Sigurinë dhe Kontrollin e Rrezikut, nën kryesimin e DKR. Ky komitet është përgjegjës për administrimin e rrezikut operacional të Grupit (duke përfshirë rrezikun e sjelljes). Ai nxjerr dhe vendos strategjinë e rrezikut operacional bazuar në profilin e rrezikut dhe strategjinë e biznesit dhe gjithashtu bën vendime lidhur me veprimet, kontrollet dhe pranimin e rrezikut.

Sigurimi i cilësisë dhe auditimi i brendshëm

Sigurimi i cilësisë në lidhje me administrimin e rrezikut ka të bëjë me sigurimin e integritetit, qëndrueshmërisë dhe saktësisë së proceseve, modeleve, llogaritjeve dhe burimeve të të dhënave. Kjo na shërben për tu siguruar që Grupi i përmbahet të gjitha kërkesave ligjore dhe se mund të arrijë standardet më të larta në operacionet e administrimit të rrezikut. Të gjitha këto aspekte koordinohen nga Divizioni i Pajtueshmërisë Bankare, i cili analizon sistemin e kontrollit të brendshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe - nëse veprimet janë të nevojshme për të adresuar ndonjë mangësi - është gjithashtu përgjegjës për përcjelljen e zbatimit të tyre.

Dy funksione shumë të rëndësishme në sigurimin e mbikëqyrjes së pavarur kryhen nga divizionet e Auditimit dhe Pajtueshmërisë: Auditimi i pavarur i brendshëm është një kërkesë ligjore dhe një shtyllë qendrore e sistemit të kontrollit të brendshëm. Auditimi i brendshëm periodikisht vlerëson të gjitha proceset e biznesit dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme për sigurimin dhe përmirësimin e tyre. I dërgon raportet e tij drejtpërdrejt në Bordin

34. ORGANIZIMI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT (VAZHDIM)

Drejtues të Grupit, i cili i diskuton ato në baza të rregullta në mbledhjet e tij të Bordit.

Zyra e Përputhshmërisë është përgjegjëse për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përmbushjen e kërkesave ligjore në plotësim dhe si pjesë integrale të sistemit të kontrollit të brendshëm. Kështu, monitorohet edhe përputhja me rregulloret ekzistuese për operacionet ditore.

35. ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM TË GRUPIT

Mbajtja e një niveli adekuat të kapitalit është një objektivi kryesor i Grupit. Kërkesat e kapitalit monitorohen rregullisht bazuar në nivelin e rrezikut të matur sipas modeleve të brendshme dhe në zgjedhjen e modeleve të përshtatshme merret parasysh rëndësia e rreziqeve që vlerësohen çdo vit. Ky koncept i administrimit të rrezikut të përgjithshëm të Grupit siguron përmbushjen e kërkesave të kapitalit si nga perspektiva rregullative (qëndrueshmëria dhe parimi i vijueshmërisë) dhe nga perspektiva ekonomike (vlerësimi objektivi). Kështu që ajo mbulon aspektet sasiore të procesit të vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit të brendshëm (ICAAP) siç kërkohet ligjërisht. Procesi i plotë i ICAAP i Grupit auditohet nga Auditimi i Brendshëm gjatë procesit të rishikimit mbikëqyrës në baza vjetore.

Që prej 31 dhjetorit 2019, përhapja e COVID-19 ka pasur ndikim të madh në shumë ekonomi në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë aktivitetet për periudha të gjata ose të pacaktuara kohore. Masat e marra për të përmirësuar përhapjen e virusit, përfshirë ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin shoqëror dhe mbylljen e shërbimeve jo thelbësore kanë shkaktuar ndërprerje të rëndësishme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Tregjet globale të aksioneve kanë pësuar gjithashtu një paqëndrueshmëri të madhe dhe një ngadalësim të ndjeshëm.

Qeveria ka njoftuar për dhënien e një garancie sovrane për të gjitha bizneset të cilat po përballen me probleme të likuiditetit dhe do të kenë nevojë për financim. Për më tepër, Banka e Shqipërisë ka njoftuar se klientët që do të përballen me probleme të likuiditetit mund të kërkojnë shtyrjen e shlyerjes së detyrimeve të tyre ndaj Bankave për një periudhë 3 mujore. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i masave të qeverisë dhe bankës qendrore, mbeten ende të veshitura të përcaktohen në kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Bankës për periudhat e ardhshme.

Korniza e sjelljes të rrezikut (KSR) kufizon rrezikun e përgjithshëm të Grupit në përputhje me objektivat strategjike të Grupit dhe cakton kapitalin e rrezikut të llogaritur sipas kategorive të ndryshme të rrezikut dhe zonave të biznesit. Qëllimi kryesor i KSR është të kufizojë rrezikun, veçanërisht në skenarët e kundërt dhe për rreziqet kryesore të njëanshme në mënyrë të tillë që të sigurojnë pajtueshmëri me raportet minimale rregullatore. Rrjedhimisht, KSR bazohet në tri shtyllat e ICAAP (vlerësimi objektivi, vijimësia e biznesit, parimin e vijmësisë) dhe përcakton limitet e rrezikut të përqendrimit për llojet e rrezikut të identifikuar si të rëndësishme në vlerësimin e rrezikut. Përveç kësaj, qëndrimi ndaj rrezikut i vendosur nga Bordi Drejtues dhe strategjia e rrezikut të Grupit dhe zbatimi i tij raportohen rregullisht në Komitetin e Rrezikut të Bordit Mbikëqyrës.

Objektivi	Rreziku	Teknika e matjes	Niveli i besimit
Perspektiva e vlerësimit të synuar	Rreziku i mos plotësimit të kërkesave nga huadhënësit kryesor të Grupit	Humbja e papritur për horizontin e rrezikut njëvjeçar (kapitali ekonomik) nuk mund të tejkalojë nivelin aktual të kapitalit dhe detyrimeve të varura	99.92 % rrjedh nga probabiliteti i vlerësimit të objektiveve të mospagimit
Perspektiva e biznesit në vijimësi	Rreziku i mosplotësimit të kërkesës së kapitalit rregullator sipas CRR	Kapaciteti i ndërmarrjes së rrezikut (fitimet e projektuar plus kapitali që tejkalon kërkesat rregullatore) nuk mund të tejkalojë vlerën e rrezikut të Grupit (horizont rreziku një vjeçar)	95 % duke reflektuar gatishmërinë e pronarëve për të ofruar fonde shtesë vetjake
Perspektiva e qëndrueshmërisë	Rreziku i rënies nën një raport të qëndrueshëm të nivelit të 1 gjatë gjithë ciklit ekonomik	Projeksionet e kapitalit dhe të ardhurave për një periudhë planifikuese trevjeçare bazuar në supozimet e një rënie të konsiderueshme ekonomike	85-90 % bazuar në vendimet e mundshme të administrimit për të ulur rrezikun përkohësisht ose për të rritur kapitalin aksioner shtesë

36. RREZIKU I KREDISË

Rreziku kreditor është rreziku më i madh për bizneset e Grupit. Rreziku kreditor nënkupton rrezikun e humbjes financiare nëse ndonjë nga klientët ose palët e treta nuk i përmbush detyrimet kontraktuale ndaj Grupit. Rreziku kreditor vjen kryesisht nga huatë dhe paradhëniet ndaj bankave, huatë dhe paradhëniet për klientët, angazhimet e huadhënies dhe garancitë financiare të dhëna. Grupi gjithashtu është i ekspozuar ndaj rreziqeve të tjera të kredisë që rrjedhin nga investimet në letrat me vlerë të borxhit dhe ekspozimet e tjera të lidhura me aktivitetet tregtare, marrëveshjet e shlyerjes dhe transaksionet e anasjellta të riblerjes.

Për fundin e vitit 2020, Banka pret një rritje të portofolit të kredive jo-performuese për shkak të rënies ekonomike. Pas shfaqjes së emergjencës së pandemisë COVID-19, grupi po analizon ndryshimet makroekonomike dhe do të pasqyrojë këto ndryshime në Stress-testet e përdorura për të përshkruar ndikimin e COVID-19 në llogaritjen e Humbjeve të Pritshme të Kredisë.

Ekspozimi total i kredisë i përdorur në administrimin e portofolit përfshin të dyja ekspozimet në dhe jashtë pasqyrës së pozicionit financiar përpara aplikimit të faktorëve të konvertimit të kredisë dhe kështu përfaqëson ekspozimin total të kredisë. Ai nuk zvogëlohet nga efektet e zbutjes së rrezikut të kredisë, si garancitë ose kolaterali fizik, efekte që megjithatë konsiderohen në vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut të kredisë. Ekspozimi total i kredisë është përdorur- nëse nuk është shprehur ndryshe- për t'u referuar ekspozimeve në të gjitha tabelat e mëposhtme në raportin e rrezikut.

Tabela e mëposhtme tregon ekspozimin total të kredisë, duke përfshirë edhe zërat jashë bilancit të klasifikuar sipas segmenteve.

në mijë Lekë	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Korporatat	71,025,331	52,332,003
Financimi i projekteve	4,839,225	5,377,549
Klientet me pakicë	63,685,989	61,615,243
Bankat	47,328,709	41,464,582
Qeveria	115,160,503	103,336,072
Total	302,039,757	264,125,449

